



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1243/ 16 prot

Datë 26/06/2026

V E N D I M
Nr. 874/2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 26/06/2026 u shqyrtua ankesa me

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Kurora” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur, mbi kufirin e lartë monetar*”, me Nr. REF-75749-02-10-2026 me objekt “*Shërbimet publike të pastrimit e gjelbërimit në bashkinë Gramsh dhe Nj.A Pishaj dhe Nj.A Kodovjat për marrëveshjen kuadër me afat 4-vjeçar*” me fond limit 197.492.000 (njëqind e nëntëdhjetë e shtatë milion e katërqind e nëntëdhjetë e dy mijë) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 30.03.2026 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Gramsh.

Autoriteti Kontraktor: Bashkia Gramsh
Adresa: Bulevardi “10 Korriku”, Gramsh.

Ankimues: Operatori Ekonomik “Alko Impex Construction” SHPK, me NUIS K91628013D, me adresë rruga “Asim Vokshi”, Alb Building”, 2T, Kati 2, Tiranë.

Subjekte të Interesuara: Operatori ekonomik “Kurora” SHPK me NUIS J76314803S, me adresë: Lagjia “Sporti”, Pallati Ri, Pranë Kishës Ortodokse, Gramsh.

Baza Ligjore:

Nenet 30 dhe 115 të ligjit nr. 162/2020 *“Për Prokurimin Publik”*, i ndryshuar; Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 *“Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*, dhe nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr.500/2020 datë 5.11.2020 *“Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”*.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesve, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:**I***Vlerësimi Paraprak*

I.1. Vlera limit e përlllogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e lartë monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 *“Për prokurimin publik”* dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka prima facie interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 *“Për prokurimin publik”*.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II*Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 11.02.2026, në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit *“Procedurë e hapur, mbi kufirin e lartë monetar”*, me Nr. REF-75749-02-10-2026 me objekt *“Shërbimet publike të pastrimit e gjelbërimit në bashkinë Gramsh dhe Nj.A Pishaj dhe Nj.A Kodovjat për marrëveshjen kuadër me afat 4-vjeçar”* me fond limit 197.492.000 (njëqind e nëntëdhjetë e shtatë milion e katërqind e nëntëdhjetë e dy mijë) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 30.03.2026 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Gramsh.

II.2. Në datën 30.03.2026 autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi.

II.3. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor si dhe sistemit të prokurimeve elektronike, rezulton se në datën 08.04.2026, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit përfundimtar të ofertave si vijon:

1. “Kurora” SHPK	147,667,441.50 lekë	kualifikuar
2. BOE “DU&KO” SHPK & “Afa Group” SHPK & “Air” SHPK	167,559,542	lekë skualifikuar
3. “Alko Impex Construction” SHPK	167,868,218	lekë kualifikuar
4. “Korsel” SHPK	185,272,263	lekë skualifikuar
5. “Rej” SHPK	197,275,330	lekë skualifikuar

II.4. Në datën 17.04.2026, autoriteti kontraktor ka publikuar në SPE njoftimin e fituesit të procedurës së mësipërme të prokurimit.

II.5. Në datën 23.04.2026 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2026/6576 dhe nr. 1243/2026 protokolli, datë 23.04.2026 e operatorit ekonomik “Alko Impex Construction” SHPK, për procedurën e mësipërme të prokurimit. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Kurora” SHPK, në procedurën e mësipërme të prokurimit me argumentat si vijon:

Nëpërmjet kësaj ankese, si kërkim të parë kërkojmë shfuqizimin e vendimit të autoritetit kontraktor për kualifikimin e ofertës së paraqitur nga OE Kurora shpk si një ofertë e cila nuk përmbush kriteret kualifikuese të parashikuara në ligj por dhe në DST Ose Anullimin e procedurës së prokurimit pasi vlerësimi i ofertave është subjektiv dhe i bërë mbi kriteret të cilat janë ta paargumentuara sesi përmbushen nga operatorët ekonomik nëpërmjet dokumentacionit të kërkuar.

Rezulton se operatori i kualifikuar nuk përmbush kriteret e kërkuara nga Autoriteti Kontraktor Bashkia Gramsh të specifikuara në DST si më poshtë vijon:

Ofertuesi deklaron se:

a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;

b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);

c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;

ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;

d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;

dh) nuk ka pagesa të pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;

e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;

g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;

gj) ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;

h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.

i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi;

k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kriteret duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 10.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Referuar kërkesave të sipërcituara të Autoritetit Kontraktor rezulton se Operatori Ekonomik nuk ka dorezuar dhe ka paraqitur vërtetim që nuk është në proces falimentimi, vendim nga gjykata që nuk është denuar për ndonjë veper penale në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së.

Po kështu rezulton se Operatori Ekonomik ka pagesa të pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, po kështu nuk ka paguar energjinë elektrike dhe nuk ka arritur të paraqesë vërtetimin për shlyerjen e tyre në përmbushje të kriterit kualifikues të kërkuar në DST.

Në këtë kuadër, sqarohet se dokumenti i paraqitur nga OE Kurora sh.p.k., që pretendohet se vërteton shlyerjen e detyrimeve të energjisë elektrike, nuk është në përputhje dhe nuk korrespondon me deklaratimet e bëra në formularin e vetëdeklarimit. Operatori Ekonomik ka detyrimin ligjor që të provojë gjendjen e tij juridike në raport me këtë kriter, pikërisht në momentin e zhvillimit të procedurës së prokurimit.

Thënë ndryshe, në mbështetje të vetëdeklarimit të tij (sipas të cilit në datën e zhvillimit të procedurës kishte shlyer detyrimet e maturuara për energjinë elektrike) Operatori Ekonomik

KURORA shpk duhej të paraqiste një akt administrativ, i cili jo vetëm të konfirmonte këtë fakt, por edhe të pasqyronte në mënyrë të qartë gjendjen e tij juridike në atë moment specifik kohor.

Në këtë kontekst, dokumentacioni i paraqitur fizikisht duhet të provojë në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe të pakontestueshme atë që është deklaruar në formularin e vetëdeklarimit. Pra, ai duhet të pasqyrojë saktësisht gjendjen e Operatorit Ekonomik në datën e zhvillimit të procedurës së prokurimit. Çdo interpretim i ndryshëm do të cenonte parimin e barazisë në garë, do të krijonte hapësira për subjektivizëm në vlerësimin e ofertave dhe do të binte ndesh me parimet themelore të prokurimit publik.

Për sa më sipër, rezulton se përmes dokumentacionit të paraqitur nga shoqëria KURORA sh.p.k. nuk është provuar gjendja e saj lidhur me detyrimet e maturuara të energjisë elektrike në momentin e zhvillimit të procedurës së prokurimit. Për rrjedhojë, oferta e paraqitur nga shoqëria KURORA shpk duhet të ishte konsideruar e parregullt e për rrjedhojë duhej të ishte vijuar me skualifikimin e saj.

Së dyti, një shkak tjetër për skualifikimin e këtij operatori ekonomik është fakti se nuk ka arritur të paraqes një vertetim Dëshmi Penaliteti për personat e kërkuar nga ligji por dhe DST. Lidhur me këtë moment, OE kishte detyrimin të provonte në mbështetje të Formularit të Vetdeklarimit se ai dhe personat e lidhur me të nuk janë të dënuar ose nuk kanë qenë të dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së dhe nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale. Mungesa e këtyre dokumentave duhet të kishte cuar në skualifikimin e ofertës së paraqitur prej tij.

Së treti, në DST në Pika 2.3.2 kërkohet: Operatori ekonomik duhet të paraqesë Liçensë e lëshuar nga Qendra Kombëtare e Liçensimit (QKL) për grumbullim dhe transportim i mbetjeve jo të rrezikshme (Kodi III.2.B) drejtuesi teknik i së cilës të rezultojë në listëpagesat në muajin e fundit.

Rezulton se provuar se ne perbushje të këtij kriteri nga ana e OE KURORA shpk është paraqitur Licensa me Nr. LN-2113-09-2016. Referuar aktit të miratimit të saj rezulton se si persona përgjegjës është shtetasi Selman Plakalliu dhe si drejtues teknik shtetasi Orgest Dedja.

Sic rezulton nga dokumentacioni i paraqitur të dy këta shtetas prej muajsh nuk kanë qenë në punësuar dhe siguruar pranë këtij subjekti. Për rrjedhojë kjo liçensë nuk mund të konsiderohet më e vlefshme. Nga ana e autoritetit kontraktor por dhe KPP duhet të bëhet verifikimi nëse këta shtetas kanë qenë të punësuar me kohë të plotë referuar dhe listëpagesave të paraqitura apo jo? Nga verifikimi do të rezultoj se këta shtetas nuk kanë qenë të punësuar me kohë të plotë gjatë gjithë periudhës pranë këtij subjekti e për rrjedhojë Licensa e tyre e ka humbur vlefshmërinë e saj. Sipas ligjit nr.10081, datë 23.2.2009 Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë , i ndryshuar, dhe VKM-së nr.538, datë 26.5.2009 Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet qendrës kombëtare të licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta , ndër kriteret kryesore të plotësimit të kushteve për liçensim është Çertifikata e drejtuesit Teknik dhe Kontratë pune me Drejtuesin Teknik (me kohë të plotë pune). Bazuar në nenin 12 të ligjit nr.10 081, datë 23.2.2009 Për licencat,

autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë të ndryshuar, licenca/autorizimi/leja revokohet kur titullari nuk përmbush më kriteret e dhënies së këtij titulli apo shkel detyrimet e përcaktuara në të. Konkretisht shtetasi Orgest Dedja nuk figuron i punësuar me kohë të plotë pranë kësaj shoqëri referuar vet dokumentacionit të paraqitur nga shoqëria KURORA shpk pas kryerjes së njoftimit paraprak të fituesit. Gjithashtu edhe personi përgjegjës shtetasi Selman Plakalliu rezulton prej vitit 2025 të mos jetë më i siguruar pranë këtij subjekti.

Së katërti, rezulton se autoriteti kontraktor në DST ka kërkuar:

Pika 2.3.6 Disponimi ose mundësia e sigurt e disponimit në paisjet/kapacitetet e mëposhtme teknike, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës:

1. Mjet teknologjik transporti veteshkarkues, për largimin e mbetjeve urbane, me ngarkim fundor ose anësor, me kapacitet mbajtës jo më pak se 10 ton - 1 (një) copë.
2. Mjet teknologjik transporti veteshkarkues rezervë, për largimin e mbetjeve urbane, me ngarkim fundor ose anësor, me kapacitet mbajtës jo më pak se 10 ton - 1 (një) copë.
3. Mjet teknologjik transporti veteshkarkues, për largimin e mbetjeve urbane, me ngarkim fundor ose anësor, me kapacitet mbajtës 3 - 4 ton - 1 (një) copë;
4. Mjet transporti me vinç për transportimin e kontenierëve për larje, pemëve, tapetit të barit, etj. me kapacitet mbajtës jo më pak se 10 Ton - 1 (një) copë;
5. Mjet teknologjik autofshesë për fshirjen e rrugëve, të pajisura me 2 fshesa anësore (majtas dhe djathtas) dhe një fshesë qendrore, sistem thithës të pluhurave (aspirator) dhe sistem spërkatje me ujë gjatë punës, me tub aspirimi të jashtëm thithës 800-1000 kg - 1 (një) copë;
6. Makina për lagjen e rrugëve, (autobot) me kapacitet mbajtës 9-10 m³ - 1 (një) copë;
7. Makineri hidrombjellje për mbjelljen e barit në sipërfaqet e pjerrëta të qytetit me kapacitet 1000-1500 litra - 1 (një) copë;
8. Kamioncinë 7 vende të ulura (6+1) dhe kapacitet mbajtës 1- 1,5 Ton për transportimin e punonjësve, mjeteve e pajisjeve të punës, etj. - 1 (një) copë;
9. Motorrsekë - 2 (dy) copë;
10. Motosharrë krasitje - 1 (një) copë;
11. Pompë dezinfektimi spërkatëse me pluhur e lëng -1 (një) copë;
12. Korrëse bari tip shkop - 1 (një) copë;
13. Korrëse bari me rrota - 2 (dy) copë;
14. Shkallë për krasitje në lartësi - 1 (një) copë;

Për mjetet e kërkuara operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin si më poshtë:

1. Mjetet në pronësi duhet të shoqërohen me akt pronësie origjinal ose kopje të noterizuar (kontrata shit-blerje ose kontrata dhurimi).
2. Mjetet me qira duhet të shoqërohen me kontratë qiraje si dhe me aktin e pronësisë së qiradhënësit (origjinal ose kopje të noterizuar). Kontrata e qerasë duhet të përmbajë objektin dhe afatin e marrjes me qera të mjeteve (e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekti këti jprokurimi).
4. Për mjetet që shënohen në regjistra publike duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin si: - leje qarkullimi; - certifikatën e kontrollit teknik; - siguracionin e mjetit; skedat teknike/katalog për të verifikuar kapacitetet e kërkuara nga AK në mungesë të tyre OE ofertues duhet të paraqesë një vetedeklarim ku të shprehen qartë kapacitetet për çdo mjet dhe AK

rezervon të drejtën për verifikimin e vetëdeklarimit në procesin e vlerësimit të dokumentacionit. Ky dokumentacion duhet të jetë i vlefshëm.

5. Per mjetet me qira, duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e tij: - certifikatën e kontrollit teknik; - siguracionin e mjetit; skedat teknike/katalog per te verifikuar kapacitetet e kerkuara nga AK ne mungese te tyre OE ofertues duhet te paraqese nje vetedeklarim ku te shprehen qarte kapacitetet per cdo mjet dhe AK rezervon të drejtën për verifikimin e vetëdeklarimit në procesin e vlerësimit të dokumentacionit - kontratën përkatëse të qerasë, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi. Ky dokumentacion duhet të jetë i vlefshëm.

6. Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar, ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.

7. Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruar sipas shtojcës Nr. 10. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese).

Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar në pronësi ose me qira ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit. Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues, i cili vërteton disponimin e mjeteve të mësipërme, do të dorëzohet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve të ankimit.

Autoriteti Kontraktor ka përcaktuar kritere të qarta dhe detyruese mbi kapacitetet teknike që duhet të disponojnë operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurë, si dhe mënyrën e provimit të tyre përmes dokumentacionit përkatës. Në këtë kuadër, ankesa jonë përqëndrohet mënyrë të veçantë tek mjetet e mëposhtme të cilat rezultojnë të theksuara me bold:

1. Mjet teknologjik autofshesë për fshirjen e rrugëve, te pajisura me 2 fshesa anësore (majtas dhe djathtas) dhe një fshesë qendrore, sistem thithës të pluhurave (aspirator) dhe sistem spërkatje me ujë gjatë punës, me tub aspirimi të jashtëm thithës 800-1000 kg - 1 (një) copë;

2. Makina për lagjen e rrugëve, (autobot) me kapacitet mbajtes 9-10 m3 - 1 (një) copë;

3. Pompë dezinfektimi spërkatëse me pluhur e lëng -1 (një) copë;

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga Operatori Ekonomik KURORA sh.p.k., nuk është provuar përmbushja e specifikimeve teknike të kërkuara nga Autoriteti Kontraktor për këto mjete, konkretisht nuk është provuar se:

a) Për mjetin teknologjik autofshesë për fshirjen e rrugëve, dokumentacioni i paraqitur për mjetin teknologjik autofshesë nuk provon se disponon sistem thithës të pluhurave (aspirator) dhe as të jetë me tub aspirimi të jashtëm thithës 800-100kg.

b) Për makinën e lagies së rrugës, dokumentacioni i paraqitur nuk provon kapacitetin mbajtës 9-10 m3

c) Për pompën e disifektimit, nuk provohet nga dokumentacioni i paraqitur se pompë e dezifektimit nuk është spërkatëse me pluhur dhe lëng.

Pavarësisht kësaj, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave (KVO) ka kryer një vlerësim tërësisht subjektiv, duke marrë të mirëqenë ekzistencën e këtyre karakteristikave, pa u mbështetur në dokumentacion provues, në kundërshtim të hapur me parimet dhe rregullat e prokurimit publik, sipas të cilave vlerësimi duhet të jetë i bazuar në prova shkresore dhe të verifikueshme.

Në përputhje me nenin 77 të Ligjit nr. 162/2020 Për Prokurimin Publik, Autoriteti Kontraktor ka detyrimin të verifikojë përmbushjen e kritereve të kualifikimit vetëm mbi bazën e

dokumentacionit provues, të paraqitur nga operatorët ekonomikë. Në mungesë të një dokumentacioni të tillë, përmbushja e kriterëve nuk mund të prezumohet dhe as të merret e mirëqënë. Një qasje e tillë përbën trajtim preferencial, cenim të parimit të barazisë, parimit të ligjshmërisë etj.

Nga ana tjetër, rezulton gjithashtu se vetë Autoriteti Kontraktor ka vendosur specifikime teknike për këto mjete/pajisje, të cilat, në raport me dokumentacionin e kërkuar, rezultojnë praktikisht të pamundura për tu verifikuar në mënyrë objektive. Kjo situatë krijon një standard vlerësimi të paqartë dhe të pambështetur në prova konkrete, duke e kthyer procesin në një vlerësim hamendësues dhe jo faktik.

Lidhur me këto arsye, rezulton se:

1. Vlerësimi i kryer nga ana e KVO ka qënë subjektiv duke marrë për të mirëqënë se këto mjete i disponojnë karakteristikat e kërkuara, duke kryer një vlerësim subjektiv, preferencial dhe të pabazuar në dokumenta shkresore, ashtu sic duhet të veprohet në cdo rast dhe për rrjedhojë kualifikimi i tij është bërë në kundërshtim me ligjin.

2. Nga ana e autoritetit kontraktor janë vendosur specifikime të këtyre mjeteve/pajisjeve dhe për të cilat me dokumentacionin e kërkuar është e pamundur të provohen specifikimet e kërkuara. Një veprim i tillë përveçse sjell subjektivizëm në vlerësim (pra vlerësimi është hamendësues dhe jo çështje fakti) por ka sjell dhe konfuzion tek pjesëmarrësit real ose të mundshëm për të garuar dhe trajtuar në mënyrë të barabartë në vlerësimin e ofertave.

Për rrjedhojë lidhur mesa më sipër kërkojmë:

a) Skualifikimin e ofertës së paraqitur prej shoqërisë KURORA shpk për mospërmbushjen e kriterëve të sipërcituara

Ose

b) Anullimin e procedurës së prokurimit pasi vlerësimi i plotësimit të kriterëve është i pamundur të realizohet nëpërmjet dokumentacionit të kërkuar

II.6. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe publikoi formularin e publikimit nr. 1243/2 prot, datë 24.04.2026 me kriteret që operatori ekonomik “Alko Impex Construction” SHPK pretendon se nuk përmbushen nga operatori ekonomik “Kurora” SHPK, të parashtruara në ankesën me nr. 1243/2026 prot, datë 23.04.2026.

II.7. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e shqyrtimit administrativ, si dhe bazuar në informacionin e Autoritetit Kontraktor u konstatua se, pranë Komisionit Prokurimit Publik është protokolluar formulari argumentave nr 1243/3 prot, datë 29.04.2026 nga subjekti i interesuar “Kurora” SHPK, në përputhje me nenin 113 ligji Nr. 162/2020, për prokurimin publik.

II.8. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e shqyrtimit administrativ, si dhe bazuar në informacionin e Autoritetit Kontraktor u konstatua se, pranë Komisionit Prokurimit Publik është protokolluar formulari argumentave nr 1243/4 prot, datë 30.04.2026 nga subjekti i interesuar “Kurora” SHPK, në përputhje me nenin 113 ligji Nr. 162/2020, për prokurimin publik.

II.9. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e shqyrtimit administrativ, si dhe bazuar në informacionin e Autoritetit Kontraktor u konstatua se, pranë Komisionit Prokurimit Publik është protokolluar formulari argumentave nr 1243/5 prot, datë 04.05.2026 nga subjekti i interesuar “Kurora” SHPK, në përputhje me nenin 113 ligji Nr. 162/2020, për prokurimin publik.

II.10. Me shkresën nr. 1715/2 prot, datë 04.05.2026, me objekt “Dërgim i vendimit nr. 1715/1, datë 04.05.2026 “Mbi shqyrtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomikë “Alko Impex Construction” shpk, lidhur me vlerësimin me objekt “Shërbimet publike të pastrimit e gjelbërimit në bashkinë Gramsh dhe Nj.A Pishaj dhe NJ.A Kodovjat për marrëveshjen kuadër me afat 4-vjeçar”, me Nr. REF-75749-02-10-2026”, protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr. 1243/6 prot., datë 04.05.2026 autoriteti kontraktor Bashkia Gramsh ka dërguar vendimin e KSHA-së, lidhur me trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues “Alko Impex Construction” SHPK. Referuar Vendimit të KSHA-së nr . 1715/1 prot, datë 04.05.2026, rezulton se pretendimet e ankimuesit janë refuzuar.

II.11. Me shkresën nr. 1715/2 prot, datë 04.05.2026, me objekt “Dërgim i vendimit nr. 1715/1, datë 04.05.2026 “Mbi shqyrtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomikë “Alko Impex Construction” shpk, lidhur me vlerësimin me objekt “Shërbimet publike të pastrimit e gjelbërimit në bashkinë Gramsh dhe Nj.A Pishaj dhe NJ.A Kodovjat për marrëveshjen kuadër me afat 4-vjeçar”, me Nr. REF-75749-02-10-2026”, protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr. 1243/7 prot., datë 06.05.2026 autoriteti kontraktor Bashkia Gramsh ka dërguar vendimin e KSHA-së, lidhur me trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues “Alko Impex Construction” SHPK. Referuar Vendimit të KSHA-së nr . 1715/1 prot, datë 04.05.2026, rezulton se pretendimet e ankimuesit janë refuzuar.

II.12. Me qëllim shqyrtimin e ankesës e operatorit ekonomik ankimues, me anë të shkresës nr. 1243/9 prot., datë 21.05.2026, Komisioni i Prokurimit Publik i ka kërkuar autoritetit kontraktor që të dërgojë pranë KPP-së dokumentacionin e dorëzuar pranë autoriteti kontraktor nga operatori ekonomik i kualifikuar i pari, në lidhje me vërtetueshmërinë e deklarimeve në shtojcën 10 Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit, sikurse përcaktohet në pikën 1 dhe 6 të nenit 26 të VKM 285, datë 19.05.2021 i ndryshuar.

II.13. Me shkresën nr. 2108/1 prot, datë 26.05.2026, me objekt “Dërgim informacioni dhe dokumentacioni”, protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr. 1243/10 prot., datë 29.05.2026 autoriteti kontraktor Bashkia Gramsh ka dërguar informacion dhe dokumentacion

gjithsej 848 faqe, në zbatim të shkresës nr. 1243/9 prot, datë 21.05.2026 të Komisionit Prokurimit Publik.

II.14. Me shkresën nr. 1243/11 prot., datë 04.06.2026 me objekt “Kërkesë për informacion” Komisioni i Prokurimit Publik me qëllim gjykimin e ankesës së paraqitur ka kërkuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor Tiranë informacionin si më poshtë:

Komisioni i Prokurimit Publik, si organi më i lartë administrativ në fushën e prokurimeve, po shqyrton ankesën me nr. 1243/2026 prot, datë 23.04.2026, për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-75749-02-10-2026, me objekt “Shërbimet publike të pastrimit e gjelbërimit në bashkinë Gramsh dhe Nj.A Pishaj dhe Nj.A Kodovjat për marrëveshjen kuadër me afat 4-vjeçar”, me fond limit 197,492 000 (njëqind e nëntëdhjetë e shtatë milion e katërqind e nëntëdhjetë e dy mijë) leke pa TVSH, zhvilluar me datë 30.03.2026 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Gramsh. Bazuar në nenin 115 të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, kërkojmë nga ana juaj të na informoni për sa më poshtë vijon:

- 1- Ku evidentohet fuqia thithëse në lejen e qarkullimit të një mjeti teknologjik ?
- 2- Si matet fuqia thithëse në një mjet teknologjik ?

Sa më sipër, në zbatim të nenit 115/1 e vijues të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, neneve 71, 72, 73 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe në cilësinë e institucionit përgjegjës, për vetë rëndësinë, që ka shqyrtimi në kohë i ankesave të operatorëve ekonomikë në përmbushje të detyrimeve që rrjedhin nga legjislacioni i prokurimit publik, si dhe për një shqyrtim më të plotë e objektiv të ankesës, lutemi të na dërgoni informacionin tuaj sa më shpejt të jetë e mundur.

Bashkalidhur do të gjeni lejen e qarkullimit nr. XXXXXX.

II.15. Me shkresën nr. 12009/1 prot, datë 10.06.2026, protokolluar me tonën me nr. 1243/12 prot, datë 12.06.2026, me objekt “Dërgim informacioni” është depozituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor Tiranë pranë Komisionin e Prokurimit Publik, informacioni me përmbajtje si më poshtë:

Në vijim të shkresës suaj Nr. 1243/11 prot, datë 04.06.2026 “Kërkesë për informacion”, protokolluar në DPSHTRR me Nr. 12009 prot, datë 08.06.2026, ju informojmë si më poshtë:

- *Nga verifikimi i fotokopjes së lejes së qarkullimit, me nr. XXXXXXXX, të dërguar nga ana juaj dhe verifikimi i Regjistrit Elektronik Kombëtar të Mjeteve, konfirmojmë se mjeti për të cilin bëhet fjalë është i llojit “Automjet për Përdorim të Veçantë (APV)”. Lloji i mjetit APV, është i evidentuar tëk fusha 1 e lejes së qarkullimit;*

- fuqia maksimale e motorit të këtij mjeti, që për rastin konkret është 55kë, evidentohet në fushën 13 të lejes së qarkullimit;
- në lejen e qarkullimit evidentohet fuqia maksimale që prodhon motori i mjetit (jo fuqi thithëse mjeti). Kjo e dhënë merret nga dokumenti teknik shoqërues i mjetit i lëshuar nga prodhuesi ose nga autoriteti kompetent i shtetit nga i cili vjen ky mjet.

II.16. Me shkresën nr. 2488 prot, datë 17.06.2026, me objekt “Kërkesë për përshpejtimin e shqyrtimit të ankimit për procedurën e prokurimit me objekt: “Shërbimet publike të pastrimit e gjelbërimit në bashkinë Gramsh dhe Nj.A Pishaj dhe Nj.A Kodovjat për marrëveshjen kuadër me afat 4-vjeçar”, protokolluar pranë Komisionit Prokurimit Publik me nr. 1243/13 prot, datë 19.06.2026, Bashkia Gramsh kërkon përshpejtimin e vendimarrjes për procedurën e prokurimit objekt ankimi.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesave, dokumentacionit bashkëngjitur tyre, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimes “Alko Impex Construction” SHPK se: “Referuar kërkesave të sipërcituara të Autoritetit Kontraktor rezulton se Operatori Ekonomik nuk ka dorezuar dhe ka paraqitur vërtetim që nuk është në proces falimentimi, vendim nga gjykata që nuk është dënuar për ndonjë veper penale në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së. Po kështu rezulton se Operatori Ekonomik ka pagesa të pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, po kështu nuk ka paguar energjinë elektrike dhe nuk ka arritur të paraqesë vërtetimin për shlyerjen e tyre në përmbushje të kriterit kualifikues të kërkuar në DST. Në këtë kuadër, sqarohet se dokumenti i paraqitur nga OE Kurora sh.p.k., që pretendohet se vërteton shlyerjen e detyrimeve të energjisë elektrike, nuk është në përputhje dhe nuk korrespondon me deklaratimet e bëra në formularin e vetëdeklarimit. Operatori Ekonomik ka detyrimin ligjor që të provojë gjendjen e tij juridike në raport me këtë kriter, pikërisht në momentin e zhvillimit të procedurës së prokurimit. Thënë ndryshe, në mbështetje të vetëdeklarimit të tij (sipas të cilit në datën e zhvillimit të procedurës kishte shlyer detyrimet e maturuara për energjinë elektrike) Operatori Ekonomik KURORA shpk duhej të paraqiste një akt administrativ, i cili jo vetëm të konfirmonte këtë fakt, por edhe të pasqyronte në mënyrë të qartë gjendjen e tij juridike në atë moment specifik kohor. Në këtë kontekst, dokumentacioni i paraqitur fizikisht duhet të provojë në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe të pakontestueshme atë që është deklaruar në formularin e vetëdeklarimit. Pra, ai duhet të pasqyrojë saktësisht gjendjen e Operatorit Ekonomik në datën e zhvillimit të procedurës së prokurimit. Çdo interpretim i ndryshëm do të cenonte parimin e barazisë në garë, do të krijonte hapësira për subjektivizëm në vlerësimin e ofertave dhe do të binte ndesh me parimet themelore të prokurimit publik. Për sa më sipër, rezulton se përmes dokumentacionit të paraqitur nga shoqëria KURORA sh.p.k. nuk është provuar gjendja e saj lidhur me detyrimet e maturuara të energjisë elektrike në momentin e zhvillimit të procedurës së prokurimit. Për rrjedhojë, oferta

e paraqitur nga shoqëria KURORA shpk duhet të ishte konsideruar e parregullt e për rrjedhojë duhej të ishte vijuar me skualifikimin e saj. Një shkak tjetër për skualifikimin e këtij operatori ekonomik është fakti se nuk ka arritur të paraqes një vertetim Dëshmi Penaliteti për personat e kërkuar nga ligji por dhe DST. Lidhur me këtë moment, OE kishte detyrimin të provonte në mbështetje të Formularit të Vetdeklarimit se ai dhe personat e lidhur me të nuk janë të dënuar ose nuk kanë qenë të dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së dhe nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale. Mungesa e këtyre dokumentave duhet të kishte cuar në skualifikimin e ofertës së paraqitur prej tij”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në shtojcën 9 “Kriteret e përgjithshme të përzgjedhjes/kualifikimit”, të dokumentave të procedurës së prokurimit, është parashikuar si vijon:

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;*
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);*
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;*
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;*
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;*
- dh) nuk ka pagesa të pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;*
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.*
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;*
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;*
- gj) ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;*
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.*
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.*
- j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi;*

k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 10.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimi nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti/Enti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

➤ Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.

➤ Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

III.1.2. Në shtojcën 10 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, pjesë e dokumenteve të tenderit, në Pjesën II, “Shkaqet e përjashtimit”, A: Deklaratë për përmbushjen e kritereve të përgjithshme të kualifikimit”, ndër të tjera, parashikohet se:

Deklarata
Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv. Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____
Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së.

Operatori Ekonomik nuk ka shfaqur mangësi të rëndësishme apo të vazhdueshme në përmbushjen e një kriteri thelbësor të një kontrate të mëparshme me një autoritet ose ent kontraktor apo një kontrate koncesionare që ka çuar në përfundimin e kësaj kontrate. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori ekonomik ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori ekonomik i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së. Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi. <i>Sqarime</i> _____ <i>nëse</i> _____ <i>vlerësohet</i> _____ <i>e</i> <i>nevojshme</i> _____

III.1.3. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik nga operatori ekonomik “Kurora” SHPK, për përmbushjen e kriterëve të mësipërme, rezulton se ky i fundit ka paraqitur në SPE dokumentacionin si më poshtë vijon:

Shtojca 10 Formualri Përmbledhës Vetëdeklarimit i plotësuar në të gjitha fushat i firmosur dhe vulosur.

A: DEKLARATA PER PERMBUSHJEN E KRITEREVE TE PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata Operatori ekonomik Kurora Shpk është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme e-albania.al; Qendra Kombëtare e Biznesit; Drejtoria Rajonale e Tatimeve</i> (Ekstrakt i Thjeshtë; Ekstrakt Historik; Vërtetim Status Aktiv)
Operatori ekonomik Kurora Shpk nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme e-albania.al; Ministria e Drejtësisë; Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve</i> (Dëshmi Penaliteti; Çertifikatë e Gjendjes Gjyqësore)
Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë: Z.1 ; Atësia: ; Amësia: ; lindur më ; Vendlindja: Gramsh me Nr.ID Z.5 ; Atësia: ; Amësia: ; lindur më ; Vendlindja: ; Gramsh me Nr.ID etj. nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë të dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme e-albania.al; Ministria e Drejtësisë; Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve; Gjykata e Rrethit Gjyqësor (Dëshmi Penaliteti; Çertifikatë e Gjendjes Gjyqësore)</i>
Operatori ekonomik Kurora Shpk nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme e-albania.al; Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve; Gjykata e Rrethit Gjyqësor</i>
(Dëshmi Penaliteti; Çertifikatë e Gjendjes Gjyqësore)
Operatori ekonomik Kurora Shpk nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv). <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme e-albania.al; Qendra Kombëtare e Biznesit; drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve</i> (Vërtetim Status Aktiv)
Operatori Ekonomik Kurora Shpk ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme e-albania.al; Drejtoria e Përgjithshme e tatimeve etj</i> (Vërtetim Pagim Detyrimesh; Vërtetim Pagim Kontributesh; Vërtetim pagim taksash vendore 2025, kështë e maturuara për 2026)
Operatori ekonomik Kurora Shpk ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme e-albania.al; Furnizuesi i Shërbimit Universal FSHIU</i> (Vërtetim Debie)
Operatori Ekonomik Kurora Shpk nuk ka shfaqur mangësi të rëndësishme apo të vazhdueshme në përmbushjen e një kriteri thelbësor të një kontrate të mëparshme me një autoritet ose ent kontraktor apo një kontrate koncesionare që ka çuar në përfundimin e kësaj kontrate. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme Formular Vlerësimi i Punes se Ngjashme, Vertetim per realizim me sukses te kontrates etj</i>
Operatori ekonomik Kurora Shpk ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme : e-albania.al; Qendra Kombëtare e Biznesit</i> (Regjistri i Pronarëve Përfitues)
Operatori ekonomik Kurora Shpk i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme e-albania.al; Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve</i> (Listëpagesa e kontributeve)

Operatori ekonomik **Kurora Shpk** nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së.

Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij.

Tel: 069 20 22 858 / 069 60 64 888 - Email: info@kurorashpk.com



aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme : E-albania (Vertetim mosperjashtimi nga prokurimet publike)

Operatori ekonomik **Kurora Shpk** ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme: Ministria e Infrastruktures dhe Energjise, QKL

(Liçenca Profesionale NZ.7852/2; Çertifikime ISO 9001 , ISO 14001, ISO 45001, ISO 39001)

Vetëdeklarim – KURORA shpk, Licensa III.2.B Licensa DDD License per prodhim tregtim fidanesh License per projektim zbatim ne pyje

- Dokumentacioni fizik i operatorit ekonomik “Kurora” SHPK dorëzuar pranë autoritetit kontraktor dhe ardhur me shkresën nr. 2108/1 prot, datë 26.05.2026 protokolluar me tonën me nr. 1243/10 prot., datë 29.05.2026, autoriteti kontraktor ka dërguar dokumentacionin e dorëzuar nga ana e operatorit ekonomik “Kurora” SHPK, gjithësej 848 faqe.

III.1.4. Në nenin 76 “Kriteret detyruese për skualifikim” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

1. Çdo operator ekonomik që është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përmendura në këtë pikë, skualifikohet nga procedurat e prokurimit publik për një periudhë 5- vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata. Ky skualifikim bëhet për veprat penale të mëposhtme:

a) pjesëmarrje në grup të strukturuar kriminal, organizatë kriminale, bandë e armatosur, organizatë terroriste, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;

b) korrupsion sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;

c) mashtrim sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;

ç) pastrim parash ose financim të terrorizmit sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;

d) vepra me qëllime terroriste ose vepra penale të lidhura me veprimtari terroriste, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;

dh) falsifikim;

e) puna e fëmijëve dhe forma të tjera të trafikimit të qenieve njerëzore sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi. Detyrimi për skualifikimin e një operatori ekonomik zbatohet edhe kur personi i dënuar me një vendim gjyqësor të formës së prerë është anëtar i një organi administrimi, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, operatori ekonomik, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij.

2. Një operator ekonomik skualifikohet nga pjesëmarrja në një procedurë prokurimi kur operatori ekonomik ka shkelur detyrimet e tij në lidhje me pagesën e taksave ose kontributeve të sigurimeve shoqërore, me përjashtim të rasteve kur:

a) operatori ekonomik është në proces gjyqësor dhe nuk ka një vendim gjyqësor ose administrativ të formës së prerë, sipas legjislacionit në fuqi;

b) operatori ekonomik i ka përmbushur detyrimet e tij, duke paguar ose duke lidhur një marrëveshje detyruese me qëllim pagimin e detyrimeve tatimore që duhet të paguajë, duke përfshirë, aty ku është e zbatueshme, çdo kamatëvonesë ose gjobë. Në çdo rast, marrëveshja detyruese me qëllim pagimin e detyrimeve tatimore duhet të jetë e nënshkruar përpara datës së shpalljes së procedurës së prokurimit;

c) operatori ekonomik nuk ka paguar shuma të vogla tatimesh ose kontributesh të sigurimeve shoqërore deri në vlerën prej 10 000 lekësh;

ç) operatori ekonomik është informuar për shumën e saktë që duhet të paguajë pas shkeljes së detyrimit të tij për të paguar taksat ose kontributet e sigurimeve shoqërore, në një kohë të tillë kur nuk ka pasur mundësi të marrë masat e nevojshme për shlyerjen e tyre, përpara skadimit të afatit për dorëzimin e kërkesës për pjesëmarrje/ofertës.

3. Çdo operator ekonomik skualifikohet nga pjesëmarrja në procedurën e prokurimit nëse është në një nga situatat e mëposhtme:

a) autoriteti ose enti kontraktor provon se ka shkelje të detyrimeve të zbatueshme që lidhen me legjislacionin për mbrojtjen nga diskriminimi, legjislacionin mjedisor, social, të punës, në fuqi apo me marrëveshjet kolektive dhe aktet e së drejtës ndërkombëtare në lidhje me këto fusha, ku Republika e Shqipërisë është palë;

b) operatori ekonomik ka falimentuar ose është subjekt i procedurave të falimentimit, kur asetet e tij administrohen nga një administrator falimentimi ose nga gjykata, kur ekziston një marrëveshje me kreditorët, kur veprimtaritë e tij të biznesit janë pezulluar ose ai ndodhet në një situatë të ngjashme që ka lindur nga një procedurë e ngjashme në zbatim të legjislacionit në fuqi, me përjashtim të rastit të parashikuar në nenin 47, pika 2, shkronja “ç”, të këtij ligji;

c) operatori ekonomik është shpallur fajtor me vendim gjyqësor të formës së prerë për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;

ç) autoriteti ose enti kontraktor provon se operatori ekonomik ka lidhur marrëveshje me operatorë ekonomikë të tjerë që kanë si qëllim të shtrembërojnë konkurrencën;

d) operatori ekonomik ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi;

dh) operatori ekonomik është tërhequr nga nënshkrimi i kontratës në një procedurë prokurimi të zhvilluar nga vetë autoriteti ose enti kontraktor. Ky kusht zbatohet brenda një viti kalendarik nga tërheqja;

e) operatori ekonomik ka shfaqur mangësi të rëndësishme apo të vazhdueshme në përmbushjen e një kriteri thelbësor të një kontrate të mëparshme me një autoritet ose ent kontraktor apo një kontrate koncesionare që ka çuar në përfundimin e kësaj kontrate, për të cilën është përjashtuar sipas parashikimeve në shkronjën “b” të pikës 1 të nenit 78 të këtij ligji.

ë) operatori ekonomik ka paraqitur deklaratat e rreme në dhënien e informacionit të kërkuar për të vërtetuar mungesën e arsyeve për skualifikim ose për plotësimin e kriterëve të përzgjedhjes, ka fshehur një informacion të tillë ose nuk është në gjendje të dorëzojë dokumentet provuese sipas kërkesave të përcaktuara në dokumentet e tenderit;

f) autoriteti kontraktor ka informacion të provuar se operatori ekonomik ka marrë përsipër të ndikojë në mënyrë të gabuar procesin e vendimmarrjes së autoritetit ose entit kontraktor për të marrë informacion konfidencial, që mund t'i japë atij avantazh të padrejtë në procedurën e prokurimit, ose nga pakujdesia të japë informacione të gabuara që mund të kenë ndikim domethënës në vendimet që lidhen me përjashtimin, përzgjedhjen ose prokurimin.

g) operatori ekonomik ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfutur fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

4. Në rrethana të jashtëzakonshme, që lidhen me arsye thelbësore të interesit publik, si shëndeti publik apo mbrojtja e mjedisit, të konfirmuara nga autoritetet kompetente, autoriteti ose enti kontraktor mund të vendosë të mos e skualifikojë operatorin ekonomik, pavarësisht parashikimeve të pikës 3 të këtij neni.

5. Autoriteti ose enti kontraktor skualifikon çdo kandidat ose ofertues, që paraqet të dhëna të rreme për qëllime kualifikimi, në çdo kohë, deri në momentin e lidhjes së kontratës dhe raporton në Agjencinë e Prokurimit Publik, për qëllimet e parashikuara në nenin 78 të këtij ligji.

6. Operatori ekonomik që ndodhet në një nga kushtet e skualifikimit të parashikuara në këtë nen mund të paraqesë prova me qëllim për të vërtetuar se masat e marra prej tij janë të mjaftueshme për të treguar besueshmërinë e tij, pavarësisht ekzistencës së kushteve për skualifikim. Për këtë qëllim, operatori ekonomik duhet të provojë që ka paguar apo ka marrë angazhim të paguajë kompensim për çdo dëm të shkaktuar si pasojë e kryerjes së një veprë penale apo shkeljeje ligjore, që ka sqaruar faktet dhe rrethanat në mënyrë gjithëpërfshirëse duke bashkëpunuar me autoritetet hetimore dhe që ka marrë masa konkrete organizative dhe për personelin të përshtatshme për parandalimin e veprave penale apo shkeljeve të tjera. Masat e marra nga operatori ekonomik duhet të vlerësohen duke marrë parasysh rëndësinë dhe rrethanat e posaçme të veprës penale apo të shkeljes. Nëse masat e marra konsiderohen të pamjaftueshme, operatorit ekonomik i jepen arsyet për një vendim të tillë.

7. Operatori ekonomik, i përjashtuar me vendim përfundimtar nga pjesëmarrja në procedurat e prokurimit apo koncesionit, nuk ka të drejtë të përdorë mundësinë e parashikuar nga pika 6 e këtij neni gjatë periudhës së përjashtimit të përcaktuar në këtë vendim.

III.1.5. Në nenin 77 pika 1 të ligjit 162/2020 të LPP-së, i ndryshuar, përcaktohet se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji.”

III.1.6. Në pikat 1 dhe 2 të nenit 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar përcaktohet se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik. Kur autoriteti ose enti kontraktor mund t'i marrë dokumentet mbështetëse duke u futur direkt në një bazë të aksesueshme të dhënash shtetërore, në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit përcaktohet edhe informacioni që kërkohet për këtë qëllim, siç është adresa në internet e bazës të të dhënave, çdo e dhënë identifikimi dhe, sipas rastit, në deklaratën e nevojshme për dhënien e pëlqimit. Operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm. 3. Në çdo kohë gjatë procedurës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë ofertuesve dhe kandidatëve sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, kur kjo është e nevojshme për të garantuar zbatimin korrekt të procedurës.

III.1.7. Në nenin 26 pika 2 dhe 6 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimi publik” i ndryshuar, parashikohet se: “2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarin, si më poshtë vijon:

- a) operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;
- c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;
- ç) operatori ekonomik nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- d) operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi;
- dh) operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së;
- e) operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë;
- ë) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;

- f) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës;
- g) operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- gj) operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor;
- h) operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti);
- i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti;
- j) informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet, nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm, nëse është rasti;
- k) operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- l) operatori ekonomik ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi;
- ll) operatori ekonomik i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë.

6. Në procedurat e prokurimit me një fazë, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i” dhe “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Në procedurat e prokurimit me fazë, ky dokumentacion i kërkohet të gjithë kandidatëve të kualifikuar në fazën e parë, përpara nisjes së afateve të ankimit. Ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të dorëzojë dokumentet provuese, të cilat duhet të jenë në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin. Për dokumentet e ofertës, të ngarkuara në sistemin e prokurimit elektronik, ofertuesi i kualifikuar i pari duhet t’i paraqesë këto dokumenta në origjinal ose të njehsuara me origjinalin. Gjithashtu, dokumentet provuese, që do të paraqiten për të provuar vetëdeklarimet e bëra, duhet të paraqiten në origjinal ose të njehsuara me origjinalin dhe të provojnë gjendjen faktike të ofertuesit në kohën e ofertimit të tij. Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike. Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj. Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.”.

III.1.8. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, nëpërmjet kriterëve për kualifikim, synohet sigurimi i ofertimit nga operatorë ekonomikë të përgjegjshëm, të cilët janë krijuar dhe veprojnë sipas legjislacionit shqiptar në fuqi apo legjislacionit të shtetit të origjinës. Kriteret kualifikuese të përcaktuara në dokumentet e tenderit janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet

e tenderit. Për pasojë, Komisioni gjykon, se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi duhet të plotësojnë vetëm kërkesat e vendosura në dokumentet e tenderit, e rrjedhimisht, vlerësimi e kualifikimi i tyre duhet të bëhet në përputhje vetëm me këto kërkesa. Nisur nga pretendimet më sipër të ankimesit, për skualifikimin e operatorit ekonomik “Kurora” SHPK, Komisioni nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në sistemin e prokurimit elektronik nga operatori ekonomik “Kurora” SHPK, konstaton, se ky i fundit ka paraqitur Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, të firmosur dhe vulosur, ku për përmbushjen e kriterëve të përgjithshme të kualifikimit ka kryer deklaratimet si në pikën III.1.3 të këtij vendimi. Duke qenë se operatori ekonomik “Kurora” SHPK, sipas vendimit të KVO-së është operatori ekonomik i kualifikuar i pari në këtë procedurë prokurimi, në zbatim të nenit 26, pika 6, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ka paraqitur pranë autoritetit kontraktor dokumentet provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i” dhe “j”, të pikës 2, të nenit 26 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, dokumente të cilat autoriteti kontraktor i ka vënë në dispozicion të KPP-së me shkresën nr. 2108/1 prot, datë 26.05.2026 me lëndë “Dërgim informacioni dhe dokumentacioni” protokolluar me tonën me nr. 1243/10 prot., datë 29.05.2026, bashkë me dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike, në brendësi të të cilit gjendet dokumentecioni për përmbushjen e kriterëve të përgjithshme të kualifikimit objekt ankese si më poshtë: **“1. Vërtetim nr. XXXXXXXX prot., datë XXXXXX.2026, nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Elbasan për operatorin ekonomik “Kurora” SHPK me NIPT J76314803S me anë të të cilit vërtetohet se personi Juridik/Fizik “Kurora” SHPK është në statusin aktiv që në datën XXXXXXXX. 2. Ekstrakt Historik i Rregjistrimit Tregtar për të Dhënat e Subjektit Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar” Kurora shpk, i datës XXXXXX.2026 me status Aktiv, me vënde të tjera të ushtrimit të aktivitetit Korçë dhe Gramsh. 3. Vërtetim nr. XXXX prot., datë XXXXXX.2026 lëshuar nga Bashkia Korçë me anë të të cilit vërtetohet se subjekti Kurora shpk me NIPT J76314803S ka likujduar tarifën vendore ndaj Bashkisë Korçë për vitin 2026, konformë legjislacionit në fuqi. 4. Vërtetim nr. XXXX prot., datë XXXXXX.2026 lëshuar nga Bashkia Gramsh me anë të të cilit vërtetohet se subjekti Kurora shpk me NIPT J76314803S ka shlyer detyrimet tatimore për taksat dhe tarifën vendore ndaj Bashkisë Gramsh për vitin 2026. 5. Vërtetim nr. --- prot., datë XXXXXX.2026 lëshuar nga Bashkia Belsh me anë të të cilit vërtetohet se subjekti Kurora shpk me NIPT J76314803S ka shlyer taksat lokale për vitin 2025 dhe nuk ka detyrime prapambetura në Sektorin e të Ardhurave Vendore, Bashkia Belsh. 6. Vërtetim nr. XXXXXXXX prot., datë XXXX.2026, nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Elbasan për operatorin ekonomik “Kurora” SHPK me NIPT J76314803S me anë të të cilit vërtetohet se personi Juridik/Fizik “Kurora” SHPK deri më datë XXXXXX.2026 ka për të paguar gjithësej 0 lekë detyrime, nga të cilat Kontribute gjithsej 0 lekë; Kamatëvonesa për kontributet 0 lekë; Gjoha lidhur me kontributet 0 lekë. 7. Vërtetim nr. XXXXXXXX prot., datë XXXX.2026, nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Elbasan për operatorin ekonomik “Kurora” SHPK me NIPT J76314803S me anë të të cilit vërtetohet se personi Juridik/Fizik “Kurora” SHPK deri më datë XXXXXX.2026 rezulton se nuk ka asnjë detyrim tatimor të papaguar. 8. Vërtetim nr. XXXX prot., datë XXXXXX.2026 nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve për operatorin ekonomik “Kurora” SHPK, ku rezulton se është i pa dënuar; 9. Vërtetim nr. XXXXXX prot., datë XXXXXX.2026 mbi gjëndjen gjyqësore për administratorin z. XXXXXXXX, lëshuar nga Drejtoria e**

Përgjithshme e Burgjeve, ku rezulton i padënuar. 10. Vërtetim nr. XXX prot., datë XXXX.2026 mbi gjëndjen gjyqësore për ortakun z. XXXXX, lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, ku rezulton i padënuar. 11. Vërtetim Debie Nr. OSHEE-XXXXXXXXX, datë XXXXX.2026 ku vërtetohet se kërkuksi Kurora shpk me NUIS J76314803S, nga verifikimet e kryera në Sistemin e Faturimit, për kontratat me kod (lista bashkalidhur) XXXXXXXX; XXXXXXXX; XXXXXXXX; XXXXXXXX; XXXXXXXX; XXXXXXXX, titullar/përdorues i të cilave është Kurora shpk, rezulton të ketë në total 0 lekë detyrime për faturat e energjisë elektrike, vlerë e llogaritur deri në datën XXXXXX.2026, përfshirë faturën korrente të muajt Shkurt 2026.

Duke marrë shkas nga pretendimet e ankimuesit, dhe duke i ballafaquar me kriteret e përgjithshme të kualifikimit, dokumentacionin e ngarkuar në sistemin e prokurimit elektronik nga ankimuesi, si dhe dokumentacionin fizik të paraqitur nga ky i fundit në autoritetin kontraktor për përmbushjen e kriterëve të përgjithshme të kualifikimit, KPP gjykon, se operatori ekonomik “Kurora” SHPK me dokumentacionin e dorëzuar në autoritetin kontraktor, i cili shërben si provë për vërtetimin e deklarimeve të bëra në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, i përmush kërkesat e autoritetit kontraktor. Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar për përmbushjen e kriterëve të përgjithshme të kualifikimit të cilat si më sipër janë objekt i ankesës, operatori ekonomik “Kurora” SHPK ka paraqitur pranë autoritetit kontraktor dokumentet provuese të parashikuara në nenit 26 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, dokumente të cilat autoriteti kontraktor i ka vënë në dispozicion të KPP-së me shkresën nr. 2108/1 prot, datë 26.05.2026 me lëndë “Dërgim informacioni dhe dokumentacioni” protokolluar me tonën me nr. 1243/10 prot., datë 29.05.2026, si dhe i ka deklaruar në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit. Duke marrë shkas nga pretendimet e ankimuesit, KPP vëren se nga ekstrakti i regjistrit historik për subjektin “Kurora” SHPK me NIPT J76314803S në pikën 10. Administratori/ë z. Ilir Dedja dhe në pikën 12. Ortakët, shfaqet z. Servet Dedja për të cilët operatori ekonomik “Kurora” SHPK sic është cituar më sipër ka paraqitur 1. Vërtetim nr. XXXXX prot., datë XXXX.2026 nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve për operatorin ekonomik “Kurora” SHPK, ku rezulton se është i padënuar; 2. Vërtetim nr. XXX prot., datë XXXXX.2026 mbi gjëndjen gjyqësore për administratorin z. XXXXX, lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, ku rezulton i padënuar; 3. Vërtetim nr. XXXX prot., datë XXXXX.2026 mbi gjëndjen gjyqësore për ortakun z. XXXXXXXX, lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, ku rezulton i padënuar. Referuar dokumentacionit të sipërcituar të operatorit ekonomik “Kurora” SHPK nuk rezulton e dënuar, gjithashtu edhe administratori dhe ortaku i kësaj shoqërie nuk rezultojnë të dënuar. KPP gjykon, se operatori ekonomik “Kurora” SHPK me dokumentacionin e dorëzuar pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit Prokurimit Publik, i cili shërben si provë për vërtetimin e deklarimeve të bëra në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, i përmbush kërkesat e autoritetit kontraktor. Komisioni vëren, se operatori ekonomik “Kurora” SHPK ka dorëzuar Vërtetimet nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, për subjektin, administratorin dhe ortakun që janë të padënuar sipas pikës 1, të nenit 76, të LPP-së. Sa më lart KPP gjykon se operatori ekonomik “Kurora” SHPK ka plotësuar rubrikën Pjesa II Shkaqet e përjashtimit të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit lidhur me plotësimin e kriterëve të përgjithshme të kualifikimit duke dhënë informacionin që ky formular kërkon, si dhe ka paraqitur dokumentacion për këtë kriter pranë autoritetit kontraktor referuar informacionit të dërguar nga ky i fundit në KPP. Në

këtë kuadër, operatori ekonomik “Kurora” SHPK i kualifikuar i pari, nga verifikimi i dokumentacionit provues të dorëzuar pranë autoritetit kontraktor për përmbushjen e kriterëve të përgjithshme të kualifikimit të cilat si më sipër kanë shëbryer si objekt i ankesës dhe nga deklaratimet e bëra në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit për përmbushjen e këtyre kriterëve, konsiderohet dokumentacion i vlefshëm, duke përmbushur kërkesat e autoritetit kontraktor.

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimes se operatori ekonomik “Kurora” SHPK nuk ka paraqitur vërtetim që nuk është në proces falimentimi, si dhe rezulton se ka pagesa të pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore. Referuar ekstraktit historik tregtar, operatori ekonomik “Kurora” SHPK, me NIPT J76314803S rezulton se ushtron aktivitetin në bashkitë si më poshtë: Bashkia Korçë dhe Bashkia Gramsh. Nga verifikimi i dokumentacionit fizik të dorëzuar nga operatori ekonomik “Kurora” SHPK, me NIPT J76314803S, rezulton se ka dorëzuar dokumentet 1. Vërtetim nr. XXXXX prot., datë XXXXX.2026 lëshuar nga Bashkia Korçë me anë të të cilit vërtetohet se subjekti Kurora shpk me NIPT J76314803S ka likujduar tarifat vendore ndaj Bashkisë Korçë për vitin XXXXX, konformë legjislacionit në fuqi. 2. Vërtetim nr. XXXXX prot., datë XXXXX.2026 lëshuar nga Bashkia Gramsh me anë të të cilit vërtetohet se subjekti Kurora shpk me NIPT J76314803S ka shlyer detyrimet tatimore për taksat dhe tarifat vendore ndaj Bashkisë Gramsh për vitin XXXX. 3. Vërtetim nr. --- prot., datë XXXXX.2026 lëshuar nga Bashkia Belsh me anë të të cilit vërtetohet se subjekti Kurora shpk me NIPT J76314803S ka shlyer taksat lokale për vitin XXXX dhe nuk ka detyrime prapambetura në Sektorin e të Ardhurave Vendore, Bashkia Belsh. 4. Vërtetim nr. XXXXXXXX prot., datë XXXXXXX.2026, nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Elbasan për operatorin ekonomik “Kurora” SHPK me NIPT J76314803S me anë të të cilit vërtetohet se personi Juridik/Fizik “Kurora” SHPK është në statusin aktiv që në datën XXXXX.2009. 5. Vërtetim nr. XXXXXXXX prot., datë XXXXXXX.2026, nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Elbasan për operatorin ekonomik “Kurora” SHPK me NIPT J76314803S me anë të të cilit vërtetohet se personi Juridik/Fizik “Kurora” SHPK deri më datë XXXXXXX.2026 ka për të paguar gjithësej 0 lekë detyrime, nga të cilat Kontribute gjithsej 0 lekë; Kamatëvonesa për kontributet 0 lekë; Gjoha lidhur me kontributet 0 lekë. 6. Vërtetim nr. XXXXXXXX prot., datë XXXX.2026, nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Elbasan për operatorin ekonomik “Kurora” SHPK me NIPT J76314803S me anë të të cilit vërtetohet se personi Juridik/Fizik “Kurora” SHPK deri më datë XXXXXXX.2026 rezulton se nuk ka asnjë detyrim tatimor të papaguar. Dokumenta këto që dëshmojnë se subjekti “Kurora” SHPK vërteton që ka paguar taksat dhe detyrimet vendore në bashkitë ku ushtron aktivitetin, si dhe vërteton se ky subjekt nuk ka detyrime të papaguara ndaj Drejtorisë Rajonale Tatimore Elbasan. KPP gjykon, se operatori ekonomik “Kurora” SHPK me dokumentacionin e dorëzuar pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit Prokurimit Publik, i cili shërben si provë për vërtetimin e deklaratimeve të bëra në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, i përmbush kërkesat e autoritetit kontraktor. Komisioni vëren, se operatori ekonomik “Kurora” SHPK ka dorëzuar Vërtetimet nga Bashkitë ku ushtronë aktivitetin dhe nga Drejtoria Rajonale Tatimore Elbasan, nëpërmjetë të cilave vërtetohet se ky subjekt nuk ka detyrime të papaguara. Sa më lart KPP gjykon se operatori ekonomik “Kurora” SHPK ka plotësuar rubrikën Pjesa II Shkaqet e përjashtimit të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit lidhur me plotësimin e kriterëve të përgjithshme të kualifikimit duke dhënë informacionin që

ky formular kërkon, si dhe ka paraqitur dokumentacion për këtë kriter pranë autoritetit kontraktor referuar informacionit të dërguar nga ky i fundit në KPP. Në këtë kuadër, operatori ekonomik “Kurora” SHPK i kualifikuar i pari, nga verifikimi i dokumentacionit provues të dorëzuar pranë autoritetit kontraktor për përmbushjen e kriterëve të përgjithshme të kualifikimit të cilat si më sipër kanë shëbryer si objekt i ankesës dhe nga deklaratimet e bëra në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit për përmbushjen e këtyre kriterëve, konsiderohet dokumentacion i vlefshëm, duke përmbushur kërkesat e autoritetit kontraktor dhe detyrimin ligjor që rrjedh nga gërma “b” dhe “dh” e nenit 26 të VKM Nr 285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar.

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues se “dokumenti i paraqitur nga OE Kurora sh.p.k., që pretendohet se vërteton shlyerjen e detyrimeve të energjisë elektrike, nuk është në përputhje dhe nuk korrespondon me deklaratimet e bëra në formularin e vetëdeklarimit. Operatori Ekonomik ka detyrimin ligjor që të provojë gjendjen e tij juridike në raport me këtë kriter, pikërisht në momentin e zhvillimit të procedurës së prokurimit. Thënë ndryshe, në mbështetje të vetëdeklarimit të tij (sipas të cilit në datën e zhvillimit të procedurës kishte shlyer detyrimet e maturuara për energjinë elektrike) Operatori Ekonomik KURORA shpk duhej të paraqiste një akt administrativ, i cili jo vetëm të konfirmonte këtë fakt, por edhe të pasqyronte në mënyrë të qartë gjendjen e tij juridike në atë moment specifik kohor. Për sa më sipër, rezulton se përmes dokumentacionit të paraqitur nga shoqëria KURORA sh.p.k. nuk është provuar gjendja e saj lidhur me detyrimet e maturuara të energjisë elektrike në momentin e zhvillimit të procedurës së prokurimit. Për rrjedhojë, oferta e paraqitur nga shoqëria KURORA shpk duhet të ishte konsideruar e parregullt e për rrjedhojë duhej të ishte vijuar me skualifikimin e saj, KPP nga verifikimi i deklaratimeve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit vëren se operatori ekonomik “Kurora” SHPK ka deklaruar dokumentacionin dhe faqen zyrtare ku mund të aksesohet ky informacion në lidhje me shlyerjen e detyrimeve të energjisë elektrike duke deklaruar konkretisht: Vërtetim Debie nga FSHU-Furnizuesi i Shërbimit Universal, dhe si operator ekonomik i kualifikuar i pari në këtë procedurë prokurimi, në zbatim të nenit 26 pika 6 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ka paraqitur pranë autoritetit kontraktor dokumentin provues Vërtetim Debie Nr. OSHEE-XXXXXXX, datë 25.03.2026 ku vërtetohet se kërkuesi Kurora shpk me NUIS J76314803S, nga verifikimet e kryera në Sistemin e Faturimit, për kontratat me kod (lista bashkalidhur) XXXXXXXX; XXXXXXXX; XXXXXXXX; XXXXXXXX; XXXXXXXX; XXXXXXXX; XXXXXXXX; XXXXXXXXXX, titullar/përdorues i të cilave është Kurora shpk, rezulton të ketë në total 0 lekë detyrime për faturat e energjisë elektrike, vlerë e llogaritur deri në datën XXXXXXX.2026, përfshirë faturën korrente të muajt Shkurt 2026.

Në nenin 11 (Leximi i Matësit dhe Faturimi i Energjisë Elektrike), paragrafi 11.1, të kontratës së miratuar me Vendimin nr. 15, datë 10.01.2018 të ERE “Për miratimin e kushteve të përgjithshme të kontratës së shërbimit universal të furnizimit me energji elektrike për klientët fundorë”, përcaktohet shprehimisht që: “11.1 Furnizuesi do të bëjë leximin periodik të matësit të energjisë elektrike të Klientit, konform parashikimeve të Kodit të Matjes, Kodit të Rrjetit si dhe legjislacionit në fuqi për Metrologjinë, për një periudhë kohore prej 30 ditësh kalendarike

dhe do ti dërgojë Klientit fundor në adresën e dhënë në kontratë, faturën tip të energjisë elektrike, brenda 10 ditëve nga data e leximit”

Në nenin 13 (*Pagesa dhe afati për kryerjen e saj*), paragrafi 13.1, të kontratës së miratuar me Vendimin nr. 15, datë 10.01.2018 të ERE “*Për miratimin e kushteve të përgjithshme të kontratës së shërbimit universal të furnizimit me energji elektrike për klientët fundorë*”, përcaktohet shprehimisht që: “*13.1 Klienti do të paguajë detyrimin e përcaktuar në faturën mujore të konsumit të energjisë elektrike jo më vonë se 30 ditë, nga data e lëshimit të faturës së fundit si dhe kur është rasti kamatëvonesat përkatëse*”.

Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se operatori ekonomik “Kurora” SHPK ka dorëzuar pranë autoritetit kontraktor një vërtetim sipas formatit të miratuar, me anë të së cilës vërtetohet, se nga verifikimet e kryera në Sistemin e Faturimit, për kontratat me kod (lista bashkalidhur) XXXXXXXXXX; XXXXXXXXXX; XXXXXXXXXX; XXXXXXXXXX; XXXXXXXXXX; XXXXXXXXXX; XXXXXXXXXX, titullar/përdorues i të cilave është Kurora shpk, rezulton të ketë në total 0 lekë detyrime për faturat e energjisë elektrike, vlerë e llogaritur deri në datën XXXXX.2026, përfshirë faturën korrente të muajt Shkurt 2026, ku referuar datës së zhvillimit të procedurës së prokurimit dt. 30.03.2026, nuk ka detyrime të papaguara, pasi sipas nenit 11 (*Leximi i Matësit dhe Faturimi i Energjisë Elektrike*), paragrafi 11.1, të kontratës së miratuar me Vendimin nr. 15, datë 10.01.2018 të ERE “*Për miratimin e kushteve të përgjithshme të kontratës së shërbimit universal të furnizimit me energji elektrike për klientët fundorë*”, përcaktohet shprehimisht se: “*Furnizuesi do të bëjë leximin periodik të matësit të energjisë elektrike të Klientit, konform parashikimeve të Kodit të Matjes, Kodit të Rrjetit si dhe legjislacionit në fuqi për Metrologjinë, për një periudhë kohore prej 30 ditësh kalendarike dhe do t’i dërgojë Klientit fundor në adresën e dhënë në kontratë, faturën tip të energjisë elektrike, brenda 10 ditëve nga data e leximit..*”, ndërsa në nenin 13 (*Pagesa dhe afati për kryerjen e saj*), paragrafi 13.1, të kontratës së miratuar me Vendimin nr. 15, datë 10.01.2018 të ERE “*Për miratimin e kushteve të përgjithshme të kontratës së shërbimit universal të furnizimit me energji elektrike për klientët fundorë*”, përcaktohet shprehimisht që: “*13.1 Klienti do të paguajë detyrimin e përcaktuar në faturën mujore të konsumit të energjisë elektrike jo më vonë se 30 ditë, nga data e lëshimit të faturës së fundit si dhe kur është rasti kamatëvonesat përkatëse.*”.

KPP, nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar pranë tij, si dhe duke u kthyer tek ankesa e paraqitur në lidhje me vlerësimin e procedurës së prokurimit objekt - shqyrtimi, lidhur me një nga pretendimet e ngritura nga operatori ekonomik ankimues, në kuadër të shqyrtimit administrativ të ankesës, dhe pasi verifikoi dokumentacion e dorëzuar nga autoriteti kontraktor konkretisht dokumentin “*Vërtetim Debie Nr. OSHEE-XXXXXXX, datë 25.03.2026 ku vërtetohet se kërkuesi Kurora shpk me NUIS J76314803S, nga verifikimet e kryera në Sistemin e Faturimit, për kontratat me kod (lista bashkalidhur) XXXXXXXXXX; XXXXXXXXXX; XXXXXXXXXX; XXXXXXXXXX; XXXXXXXXXX; XXXXXXXXXX; XXXXXXXXXX, titullar/përdorues i të cilave është Kurora shpk, rezulton të ketë në total 0 lekë detyrime për faturat e energjisë elektrike, vlerë e llogaritur deri në datën XXXXXXX.2026, përfshirë faturën korrente të muajt Shkurt 2026,*”. Referuar informacionit të dhënë nga Furnizuesi Shërbimit Universal Sh.A., i cili menaxhon sistemin e të dhënave për pagimin e energjisë elektrike për të gjithë subjektet

përdoruese të energjisë elektrike, për të gjithë kontratat e lidhura midis Furnizuesit të Shërbimit Universal SHA dhe subjekteve përdoruese të energjisë elektrike, me anë të së cilës vërtetohet, se subjekti “Kurora” SHPK nuk rezulton debitor për 7 kontratat, Komisioni Prokurimit Publik gjykon, se operatori ekonomik “Kurora” SHPK me dokumentacionin e dorëzuar në autoriteti kontraktor, i cili shërben si provë për vërtetimin e deklarimeve të bëra në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, i përmush kërkesat e autoritetit kontraktor. Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar për përmushjen e kriterëve të përgjithshme të kualifikimit, operatori ekonomik “Kurora” SHPK ka paraqitur pranë autoritetit kontraktor dokumentet provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, të pikës 2, të nenit 26 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, dokumente të cilat autoriteti kontraktor i ka vënë në dispozicion të KPP-së, nga verifikimi i të cilave rezulton se operatori ekonomik “Kurora” SHPK i përmbush kërkesat e autoritetit kontraktor. Në përfundim të hetimit, KPP konstaton se, në kushtet kur operatori ekonomik “Kurora” SHPK ka dorëzuar pranë autoritetit kontraktor një vërtetim të lëshuar nga Furnizuesi i Shërbimit Universal SHA sipas formatit të miratuar, si dhe referuar informacionit të dhënë nga institucioni i Furnizuesit të Shërbimit Universal SH.A i cili menaxhon sistemin e të dhënave për pagimin e energjisë elektrike për të gjithë subjektet përdoruese të energjisë elektrike, për të gjithë kontratat e lidhura midis Furnizuesit të Shërbimit Universal SHA dhe subjekteve përdoruese të energjisë elektrike, rezulton se subjekti “Kurora” SHPK nuk rezulton debitor, përfshirë edhe muajin e fundit të maturuar, referuar datës së zhvillimit të procedurës së prokurimit pretendimet e operatorit ekonomik ankimes nuk qëndrojnë.

Për sa më sipër pretendimet e operatorit ekonomik ankimes “Alko Impex Construction” SHPK nuk qëndrojnë.

III.2. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik “Alko Impex Construction” SHPK se: “Së treti, në DST në Pika 2.3.2 kërkohet: Operatori ekonomik duhet të paraqesë Liçensë e lëshuar nga Qendra Kombëtare e Liçensimit (QKL) për grumbullim dhe transportim i mbetjeve jo të rrezikshme (Kodi III.2.B) drejtuesi teknik i së cilës të rezultojë në listëpagesat në muajin e fundit. Rezulton se provuar se ne perbushje të këtij kriteri nga ana e OE KURORA shpk është paraqitur Licensa me Nr. LN-2113-09-2016. Referuar aktit të miratimit të saj rezulton se si persona përgjegjës është shtetasi Selman Plakalliu dhe si drejtues teknik shtetasi Orgest Dedja. Sic rezulton nga dokumentacioni i paraqitur të dy këta shtetas prej muajsh nuk kanë qënë në punësuar dhe siguruar pranë këtij subjekti. Për rrjedhojë kjo licensë nuk mund të konsiderohet më e vlefshme. Nga ana e autoritetit kontraktor por dhe KPP duhet të bëhet verifikimi nëse këta shtetas kanë qënë të punësuar me kohë të plotë referuar dhe listëpagesave të paraqitura apo jo? Nga verifikimi do të rezultoj se këta shtetas nuk kanë qënë të punësuar me kohë të plotë gjatë gjithë periudhës pranë këtij subjekti e për rrjedhojë Licensa e tyre e ka humbur vlefshmërinë e saj. Sipas ligjit nr.10081, datë 23.2.2009 Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë , i ndryshuar, dhe VKM-së nr.538, datë 26.5.2009 Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet qendrës kombëtare të licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta , ndër kriteret kryesore të plotësimit të kushteve për liçensim është Çertifikata e drejtuesit Teknik dhe Kontratë pune me Drejtuesin Teknik (me kohë të plotë pune). Bazuar në nenin 12 të ligjit nr.10 081, datë 23.2.2009 Për licencat,

autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë të ndryshuar, licenca/autorizimi/leja revokohet kur titullari nuk përmbush më kriteret e dhënies së këtij titulli apo shkel detyrimet e përcaktuara në të. Konkretisht shtetasi Orgest Dedja nuk figuron i punësuar me kohë të plotë pranë kësaj shoqëri referuar vet dokumentacionit të paraqitur nga shoqëria KURORA shpk pas kryerjes së njoftimit paraprak të fituesit. Gjithashtu edhe personi përgjegjës shtetasi Selman Plakalliu rezulton prej vitit 2025 të mos jetë më i siguruar pranë këtij subjekti”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.2.1. Në shtojcën 9/2 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, pika 2.3.2 “Kapaciteti teknik dhe profesional”, e modifikuar të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë Liçensë e lëshuar nga Qendra Kombëtare e Liçensimit (QKL) për grumbullim dhe transportim i mbetjeve jo të rrezikshme (Kodi III.2.B) drejtuesi teknik i së cilës të rezultojë në listëpagesat në muajin e fundit .

III.2.2. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik nga operatori ekonomik “Kurora” SHPK, për përmbushjen e kriterit të mësipërm, rezulton, se ky i fundit ka paraqitur dokumentacion si më poshtë vijon:

Licencë me Kodin III.2.B (1) LN-2113-09-2016, subjekti “Kurora” SHPK, me emërtim përshkrues të veprimtarisë “Grumbullim dhe transportim i mbetjeve urbane”, vendi i kryerjes së veprimtarisë Bashkia Gramsh, Qarku Elbasan.

Akt - Miratimi Nr. 6224 prot, datë 26.09.2016, për licencën e kategorisë III.2.B. Për personin juridik “Kurora” SHPK me NIPT J763148035. Aktiviteti i licensuar “Grumbullim, përpunim dhe transportim i mbetjeve urbane”. Vendodhja Bashkia Gramsh, Qarku Elbasan. Lloji i Mbetjeve “Mbetje urbane të parrezikshme”. Person Përgjegjës “Selman Plakalliu. Drejtues Teknik “Orgest Dedja”.

Licencë me Kodin III.1.A (1) PN-9229-02-2015, subjekti “Kurora” SHPK, me emërtim përshkrues të veprimtarisë “Leje mjedisit e tipit C për aktivitetin: Pastrim, larje, sprucim ose veshje e mbetjeve të ambalazhuara/paketimeve ose kontenierëve në mënyrë që të ripërdoren Magazinim i mbetjeve në lidhje me zbatimin e veprimtarisë. Stacion Transferimi për mbetjet jo të rrezikshme. Kompostim i mbetjeve bio”, vendi i kryerjes së veprimtarisë Bashkia Gramsh, Qarku Elbasan.

Licencë me Kodin II.8.B (1) LN-8661-10-2014, subjekti “Kurora” SHPK, me emërtim përshkrues të veprimtarisë “Deratizim, dezinfektim, dezinfektim”, vendi i kryerjes së veprimtarisë në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

Licencë me Kodin III.7.A (1) LN-7076-11-2013, subjekti “Kurora” SHPK, me emërtim përshkrues të veprimtarisë “a. Shërbime profesionale për projekte. b. Shërbime profesionale për zbatim”, vendi i kryerjes së veprimtarisë në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

Licencë me Kodin II.4 (1) LN-2029-09-2016, subjekti “Kurora” SHPK, me emërtim përshkrues të veprimtarisë “Prodhim dhe tregtim i farave dhe fidanëve”, vendi i kryerjes së veprimtarisë Bashkia Gramsh, Qarku Elbasan.

Deklarata “Listpagesa e Kontributeve të Sigurimeve Shoqërore, Shëndetësore dhe Tatimore mbi të ardhurat nga Punësimi” për periudhat tatimore Dhjetor 2025, Janar 2026, Shkurt 2026, Mars 2026. Lëshuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore Elbasan.

III.2.3. Në nenin 2 “Qëllimi i ligjit” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se: Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit public.

III.2.4. Në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se 1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisorsocial e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.

III.2.5. Në nenin 77 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të

zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

III.2.6. Neni 41 “Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve”, të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se: “2. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77 të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve. 4. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a) licenca profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. d) Në rastin e prokurimit të shërbimeve me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posacme 41stafi i angazhuar të paraqesë deklaratë disponueshmërie për kryerjen e shërbimeve që ka marrë përsipër të realizojë.

III.2.7. Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së, i ndryshuar, përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”.

III.2.8. Në nenin 20 “Shqyrtimi dhe vendimmarrja për grupin e tretë”, seksioni 2 të ligjit Nr. 10 081, datë 23.2.2009 “Për Licencat, Autorizimet dhe Lejet në Republikën e Shqipërisë”, parashikohet shprehimisht:

1. QKL-ja merr në shqyrtim paraprak, sipas pikës 1 të nenit 19 të këtij ligji, kërkesat për grupin e tretë, sipas radhës së paraqitjes së tyre.
2. QKL-ja vlerëson vetëm përmbushjen e kriterëve në kompetencë të saj, e bazuar në vetëdeklarimin e kërkuarit dhe/apo dokumentet provuese, sipas të njëjtave procedura dhe afate, sipas rastit, të përcaktuara për grupin e parë ose të dytë. Vlerësimi i përmbushjes së kriterëve të tjera të licencimit/autorizimit/lejes bëhet sipas pikave 4 e 5 të këtij neni.
3. Nëse QKL-ja konstaton njërën nga shkaqet e refuzimit, ajo vendos refuzimin përfundimtar të kërkesës.
4. Në rast të kundërt, QKL-ja publikon në regjistër vendimin paraprak të kalimit në fazën e dytë të shqyrtimit dhe njofton, në mënyrë elektronike, institucionet e tjera, që shqyrtojnë përmbushjen e një apo të disa kriterëve të licencimit/autorizimit/lejimit, në kompetencë të tyre.

5. Institucionet e tjera, brenda afatit të caktuar, shqyrtojnë përmbushjen e kriterëve të licencimit/autorizimit/lejimit, në kompetencën e tyre duke kryer vlerësimin, inspektimin, duke organizuar testimin apo garën, intervistën apo dëgjimin, ose duke zbatuar metodën tjetër përkatëse dhe shprehin miratimin apo refuzimin e tyre për përmbushjen ose mospërmbushjen e kriterëve përkatëse. Refuzimi parashikon edhe shkaqet e tij. Refuzimi apo miratimi publikohet menjëherë nga vetë institucioni në regjistër.

6. Nëse akti i miratimit apo i refuzimit nga njëri nga institucionet është, paraprakisht, i domosdoshëm për shqyrtimin e të njëjtit kriter apo të një kriteri tjetër licencimi/autorizimi/lejimi nga një institucion tjetër, afati i caktuar për këtë të fundit fillon nga publikimi në regjistër i miratimit apo i refuzimit të institucionit të parë.

7. Afati i caktuar, sipas pikave 5 e 6 të këtij neni, është afati për shqyrtimin e përmbushjes ose jo të kriterit përkatës nga institucioni tjetër dhe përcaktohet nga Këshilli i Ministrave për çdo kategori/nënkategori. Afati fillon të llogaritet nga data e publikimit të vendimit të QKL-së, sipas pikës 4 të këtij neni.

8. Mospublikimi i përgjigjes brenda afateve të përcaktuara në pikën 5 apo 6 të këtij neni, apo kur refuzimi nuk përmban shkakun e refuzimit, vlerësohet si miratim në heshtje i institucionit tjetër.

9. Jo më vonë se 2 ditë nga kalimi i afatit të fundit dhe më të gjatë, sipas pikës 5 apo 6 të këtij neni, QKL-ja merr një vendim përfundimtar për kërkesën e paraqitur.

10. Nëse, qoftë edhe një nga institucionet e tjera ka vendosur refuzimin dhe shkaqet e tij, QKL-ja vendos refuzimin e kërkesës, në rast të kundër QKL-ja vendos, përkatësisht, miratimin.

III.2.9. Në nenin 30 “Ankimi”, seksioni 5 të ligjit Nr. 10 081, datë 23.2.2009 “Për Licencat, Autorizimet dhe Lejet në Republikën e Shqipërisë”, parashikohet shprehimisht:

1. Çdo palë e interesuar ka të drejtë të ankohet në rrugë administrative ndaj akteve, veprimeve apo mosveprimeve të QKL-së apo institucionit tjetër në rastin e grupit të tretë.

2. Ankimi administrativ shqyrtohet nga titullari i QKL-së, me përjashtim të rastit të parashikuar në pikën 3 të këtij neni.

3. Në rastin e refuzimit të parashikuar në pikën 10 të nenit 20 të këtij ligji, ankimi shqyrtohet nga institucioni tjetër, që e ka vendosur refuzimin.

4. Ankimi, në të gjitha rastet, paraqitet me kërkesë në QKL, sipas mënyrës së parashikuar në këtë ligj. Në rastin e parashikuar në pikën 3 të këtij neni, QKL-ja publikon ankimin dhe njofton, në mënyrë elektronike, institucionin tjetër kompetent.

5. Ndaj vendimit të dhënë pas shqyrtimit të ankimit administrativ apo mosveprimit mund të bëhet ankim drejtpërdrejt në gjykatën kompetente për çështjet administrative, sipas legjislacionit në fuqi.

III.2.10. Në shtojcën e ligjit Nr. 10 081, datë 23.2.2009 “Për Licencat, Autorizimet dhe Lejet në Republikën e Shqipërisë”, Fusha III “Mjedisi dhe burime mjedisore bazë”, parashikohet shprehimisht:

12 1. Leje Për ndikimin në mjedis.

13 2. Licence Shërbime ekspertize dhe/ose profesionale lidhur me ndikimin në mjedis.

14 3. Licence Importi i mbetjeve për qëllim riciklimi, përpunimi, dhe/ose përdorimi ose importi i substancave ozon-holluese.

III.2.11. Në aneksin 1 të VKM Nr.538, datë 26.5.2009 “Për Licencat dhe Lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet qendrës Kombëtare të Licencimit dhe disa rregullime të tjera nënligjore të Përbashkëta”, Fusha III “Mjedisi dhe burime mjedisore bazë”, Kategoria III.2 “Shërbime ekspertize dhe/ose profesionale lidhur me ndikimin në mjedis.”, parashikohet shprehimisht:

1. Veprimtaria e “shërbimeve të ekspertizës dhe/ose profesionale lidhur me ndikimin në mjedis” është kategoria III.2 e shtojcës së ligjit nr.10 081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”.

2. Kategoria e kësaj veprimtarie ndahet në dy nënkategori si vijon:

a) “veprimtaritë e ekspertizës lidhur me ndikimin në mjedis” me kodin III.2.A;

b) “veprimtaritë e tjera profesionale lidhur me ndikimin në mjedis”, me kodin III.2.B.

3. Licencat e kategorisë III.2 jepen pa afat kohor.

8. Licencat për nënkategorinë III.2.B jepet për çdo vend ku kryhet veprimtaria.

9. Veprimtaria e nënkategorisë III.2.B specifikohet në veprimtari të tilla si grumbullim, transportim, ruajtje, riciklim, përpunim apo asgjësim i mbetjeve të llojeve të ndryshme.

10. Kriteret e posaçme të licencimit, si dhe llojet e dokumenteve provuese dhe dokumentet e tjera shoqëruese për kategorinë III.2.B, përcaktohen në tabelën 2.

11. Licencimi i nënkategorisë III.2.B bëhet sipas procedurës së grupit III.

a) Institucioni tjetër, që verifikon plotësimin e kriterëve të licencimit për nënkategorinë III.2.B është struktura e Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave e caktuar me udhëzim të ministrit sipas kompetencës territoriale në vendin ku ushtrohet veprimtaria. Vendimi bazohet në dokumentet provuese dhe në inspektimin në vend për vlerësimin e përmbushjes së kriterëve përkatëse të licencimit.

b) Afati i marrjes së vendimit është 30 ditë.

IV. Data e Fillimit të Licencimit sipas këtij Vendimi

12. Licencimi i veprimtarive sipas këtij vendimi fillon më datë 9.6.2009.

III.2.12. KPP gjykon se vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses

të kontratës. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit.

III.2.13. KPP gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Gjithashtu një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë, se operatorët ekonomikë duhej të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. KPP gjykon, se autoriteti kontraktor në përputhje me nenin 2 dhe 3 të ligjit 162/2021 “Për prokurimin publik” ka për detyrë d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dhe të garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe të veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. Referuar kriterëve të veçanta të kualifikimit, autoriteti kontraktor ka kërkuar se: *“Operatori ekonomik duhet të paraqesë Liçensë e lëshuar nga Qendra Kombëtare e Liçensimit (QKL) për grumbullim dhe transportim i mbetjeve jo të rrezikshme (Kodi III.2.B) drejtuesi teknik i së cilës të rezultojë në listëpagesat në muajin e fundit”*. Referuar proces-verbalit të argumentimit të kriterëve të vecanta të kualifikimit, publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, rezulton se autoriteti kontraktor për kriterin e mësipërm ka arsyetuar se: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në piken 2, të nenit 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar: “Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionale ose tregtarë”, dhe nenin 41, pika 4, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar; të ligjit nr.10081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; VKM Nr. 538, datë 26.05.2009, “Për Licencat dhe Lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, e ndryshuar; Ligjin Nr. 57, datë 16.10.2025, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”; Ligji nr. 10 431, date 9.6.2011 “Per mbrojtjen e mjedisit”; Ligjin Nr 10448, datë 14.07.2011, “Për Lejet e Mjedisit”. Licenca e kerkuar me kodin III.2.B eshte ne perputhje me zerat e preventivit te realizimit te sherbimit dhe specifikimet teknike ku kerkohet pastrimi, grumbullimi dhe transporti i mbetjeve urbane te klasifikuara si jo te rrezikshme. Referuar sa më lart, Komisioni i Prokurimit Publik vëren, se objekti i prokurimit të procedurës*

objekt-ankimi është Shërbimi i pastrimit të territorit të Bashkisë Gramsh dhe autoriteti kontraktor në kriterin e veçantë të kualifikimit ka kërkuar nga ana e operatorëve ekonomikë të paraqesin *Liçensë e lëshuar nga Qendra Kombëtare e Liçensimit (QKL) per grumbullim dhe transportim i mbetjeve jo të rrezikshme (Kodi III.2.B) drejtuesi teknik i së cilës të rezultojë në listëpagesat në muajin e fundit*. Nga shqyrtimi në tërësi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik “Kurora” SHPK në përmbushje të kriterit sa më sipër, rezulton se operatori ekonomik “Korara” SHPK ndër të tjera ka dorëzuar edhe *Licencë me Kodin III.2.B (1) LN-2113-09-2016, subjekti “Kurora” SHPK, me emërtim përshkrues të veprimtarisë “Grumbullim dhe transportim i mbetjeve urbane”, vendi i kryerjes së veprimtarisë Bashkia Gramsh, Qarku Elbasan. Akt - Miratimi Nr. 6224 prot, datë 26.09.2016, për licencën e kategorisë III.2.B. Për personin juridik “Kurora” SHPK me NIPT J763148035. Aktiviteti i licensuar “Grumbullim, përpunim dhe transportim i mbetjeve urbane”. Vendodhja Bashkia Gramsh, Qarku Elbasan. Lloji i Mbetjeve “Mbetje urbane të parrezikshme”. Person Përgjegjës “XXXXXXX”. Drejtues Teknik “XXXXXXX” të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit. Deklarata “Listpagesa e Kontributeve të Sigurimeve Shoqërore, Shëndetësore dhe Tatimore mbi të ardhurat nga Punësimi” për periudhat tatimore Dhjetor 2025, Janar 2026, Shkurt 2026, Mars 2026. Lëshuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore Elbasan*. Nga shqyrtimi i kriterit të mësipërm, vërejmë se autoriteti kontraktor ka kërkuar në mënyrë eksplicite *Liçensë e lëshuar nga Qendra Kombëtare e Liçensimit (QKL) per grumbullim dhe transportim i mbetjeve jo të rrezikshme (Kodi III.2.B) drejtuesi teknik i së cilës të rezultojë në listëpagesat në muajin e fundit*. Sa më sipër, rezulton se operatori ekonomik është i licensuar për kategorinë III.2.B ashtu sikurse është kërkuar nga autoriteti kontraktor. Në këtë kuptim KPP gjykon, se operatori ekonomik “Kurora” SHPK është në kushtet e përmbushjes së kërkesave në kriterin e veçante të kualifikimit të përcaktuar në dokumentet e procedurës së prokurimit objekt-ankimi, sa i takon Licencës së kategorisë III.2.B të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit, pasi nga verifikimet e kryera, konstatojmë se Licenca III.2.B (1) LN-2113-09-2016, “Kurora” SHPK, me akt - miratimi Nr. 6224 prot, datë 26.09.2016, me emërtim përshkrues të veprimtarisë “Grumbullim, përpunim dhe transportim i mbetjeve urbane”, të lëshuar nga QKL (Sot QKB) për këtë operator ekonomik është aktive edhe në momentin e vendimarrjes, verifikuar kjo në Regjistrin e Lejeve dhe Licencave të lëshuar nga QKB, në faqen zyrtare të internetit të Qendrës Kombëtare të Biznesit. Gjithashtu dhe nga listpagesat e dorëzuara nga operatori ekonomik “Kurora” SHPK rezulton se pjesë e listpagesave të këtij operatori ekonomik janë të deklaruar edhe punonjësit XXXXXX në rolin e Drejtuesit Teknik dhe XXXXXX në rolin e Personit Përgjegjës. Në këtë mënyrë, vlerësojmë se nuk mund të shprehim dhe të vlerësojmë nëse një akt administrativ i lëshuar nga një organ tjetër administrativ, i cili nuk ka mardhënie hierarkike me Komisionin e Prokurimit Publik është ose jo në përputhje me legjislacionin sektorial. Gjithashtu, ligji i prokurimit publik, aktet nënligjore në zbatim të tij nuk parashikojnë në asnjë rast kompetencën e KPP-së për t’u shprehur në lidhje me vlefshmërinë e licencave. Vlerësojmë se konstatimet se licencat e paraqitur nga operatori ekonomik “Kurora” SHPK nuk është në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 10081, datë 23.2.2009 “Për Licencat, Autorizimet dhe Lejet në Republikën e Shqipërisë”, dhe VKM Nr.538, datë 26.5.2009 “Për Licencat dhe Lejet që trajtohen nga apo nëpërmjetë qendrës Kombëtare të Licencimit dhe disa rregullime të tjera nënligjore të Përbashkëta” nuk janë të mbështetur në ligj dhe vkm, si edhe janë jashtë kompetencave lëndore të Komisionit të Prokurimit Publik. Në nenin 113 të Kodit të Procedurave Administrative parashikohet se: “Një

akt administrativ mund të anulohet apo shfuqizohet, kryesisht nga organi publik që ka kompetencë të nxjerrë aktin, nga organi i tij epror apo nga një organ tjetër i parashikuar shprehimisht me ligj.” Sa më sipër, vlerësojmë se ex ante përpara lidhjes së kontratës operatori ekonomik do të ushtronte veprimtari në kundërshtim me ligjin, atëherë kjo do të duhej të konstatohej nga organi publik i caktuar nga akti nënligjor i cili ka miratuar licencën si edhe nga ana tjetër nuk do të cënohej interesi publik, i lidhjes së kontratës me një operator ekonomik i cili nuk disponon kapacitetet ligjore/ teknike të nevojshëm. Për efektë të përmbushjes së kriterit të përcaktuar në pikën 2.3.2 të dokumentave standarte të tenderit, dokumentacioni i dorëzuar nga operatori ekonomik “Kurora” SHPK do të konsiderohet i vlefshëm, pasi ky operator ekonomik disponon licencë III.2.B, si dhe ka deklaruar në listpagesa drejtuesin teknik dhe personin përgjegjës.

Lidhur me pretendimin e ankimuesit për papajtueshmërinë e drejtuesit teknik Komisioni Prokurimit Publik për një shqyrtim të drejtë të pretendimeve të bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues, gjykon ti drejtohet për interpretim parashikimeve ligjore të legjislacionit sectorial, dhe konkretisht, aktit nënligjor në zbatim të ligjit, ku në kreun IV “*Drejtuesi teknik dhe pa pajtueshmëria me këtë detyrë*” të Vendimit nr. 42 datë 16.01.2008 të Këshillit të Ministrave “*Për Miratimin e Rregullores për Kriteret dhe Procedurat e Dhënies së Licencave Profesionale të Zbatimit, Klasifikimit dhe Disiplinimit të Subjekteve Juridike, që Ushtrojnë Veprimtari Ndërtimi*”, i ndryshuar parashikohet se: “2. *Papajtueshmëritë me detyrën e drejtuesit teknik të shoqërisë së zbatimit Drejtuesit teknik të shoqërisë nuk mund të jenë personat që janë të angazhuar në çdo punë marrje tjetër publike. Drejtuesi teknik i shoqërisë nuk mund të jetë njëkohësisht i punësuar në dy apo më shumë shoqëri ndërtimi dhe ndalohet të disponojnë licencë për mbikëqyrje e kolaudim të punimeve të zbatimit*”. Referuar parashikimit të mësipërm ligjor, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se rregullat e posaçëm të cilët parashikojnë njëherazi edhe procedurën e licencimit të shoqërive në ndërtim strictu senso, parashikojnë ndalime strikte të dy punësimit të drejtuesve teknik të shoqërisë veçanërisht ato të punësimit të tyre në subjekte private dhe njëherazi në institucione publike. Rregullimi i mësipërm është parashikuar në kreun i cili parashikon edhe kushtet e papajtueshmërisë së detyrës së drejtuesit teknik të shoqërive që Ushtrojnë Veprimtari Ndërtimi. Ndërkohë në rastin konkret objekt shqyrtimi nuk ndodhemi përpara faktit të licensimi të operatorëve ekonomik ankimues sipas VKM Nr. 42, datë 16.01.2008 e cila fushën e veprimtarisë e ka për shoqëritë që Ushtrojnë Veprimtari Ndërtimi. Pasi objekti prokurimit për të cilën KPP është venë në lëvizje për të shlyrtuar ankesën lidhet me shërbim pastrimi dhe vetë autoriteti kontraktor në proceverbalin e argumentimit të krirtereve ka përcaktuar aktet ligjore dhe nënligjore si më poshtë: *Operatori ekonomik duhet të paraqesë Liçensë e lëshuar nga Qendra Kombëtare e Liçensimit (QKL) për grumbullim dhe transportim i mbetjeve jo të rrezikshme (Kodi III.2.B) drejtuesi teknik i së cilës të rezultojë në listëpagesat në muajin e fundit*”. Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 2, të nenit 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar: “*Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë*”, dhe nenin 41, pika 4, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik*”, i ndryshuar; të ligjit nr.10081, datë 23.2.2009 “*Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën*

e Shqipërisë”, i ndryshuar; VKM Nr. 538, datë 26.05.2009, “Për Licencat dhe Lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, e ndryshuar; Ligjin Nr. 57, datë 16.10.2025, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, Ligji nr. 10 431, date 9.6.2011 “Per mbrojtjen e mjedisit”; Ligjin Nr 10448, datë 14.07.2011, “Për Lejet e Mjedisit”. Licenca e kërkuar me kodin III.2.B është ne perputhje me zerat e preventivit te realizimit te sherbimit dhe specifikimet teknike ku kerkohet pastrimi, grumbullimi dhe transporti i mbetjeve urbane te klasifikuara si jo te rrezikshme. Ndaj dhe Komisioni gjykon se operatori ekonomik “Kurora” SHPK me anë të dokumentacionit të paraqitur, vërteton se plotëson me sukses kërkesat e përcaktuara nga autoriteti kontraktor, në dokumentet standarde të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-shqyrtimi. Akoma më tej nuk rezulton se autoriteti kontraktor të ketë parashikuar në dokumentet e tenderit kërkesa që punonjësit duhet të jenë më kohët të plotë apo të pjesshme, gjë e cila do të përbënte detyrim për tu përmbushur nga operatorët ekonomikë nëse do të kërkoreshin në DT. Pavarsisht kësaj Komisioni verifikoi Deklatën “Listëpagesa e Kontributeve të Sigurimeve Shoqërore, Shëndetësore dhe Tatimit mbi të Ardhurat nga Punësimi” e muajve Dhjetor 2025 – Mars 2026 konkretisht rubrikën nr. 14) Ditë kalendarike të punuara gjatë muajit nga punonjësi, nga ku rezultoi se Personi Përgjegjës z. XXXXXXXX dhe Drejtuesi Teknik z. XXXXXXXX figurojnë me 22 (njëzetë e dy) ditë pune në listëpagesa. Në mënyrë eksplicite ligji për prokurimin publik parashikon se vlerësimi i ofertave duhet bërë vetëm në përputhje me kriteret e kualifikimit të parashikuara në dokumentet e procedurës përkatëse. Vlerësimi i ofertave referuar kriterëve të tjera të kualifikimit të cilat në asnjë rast nuk janë parashikuar në dokumentet e procedurës së prokurimit cenon parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit, parashikuar nga neni 3 i lex specialis, atë të barazisë në trajtimin e kërkesave dhe detyrimeve që i ngarkohen ofertuesve.

Sa më lart, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “Alko Impex Construction” SHPK nuk qëndron.

III.3. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Alko Impex Construction” SHPK se: “Së katërti, Autoriteti Kontraktor ka përcaktuar kritere të qarta dhe detyruese mbi kapacitetet teknike që duhet të disponojnë operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurë, si dhe mënyrën e provimit të tyre përmes dokumentacionit përkatës. Në këtë kuadër, ankesa jonë përqendrohet mënyrë të veçantë tek mjetet e mëposhtme të cilat rezultojnë të theksuara me bold: 1. Mjet teknologjik autofshesë për fshirjen e rrugëve, te pajisura me 2 fshesa anësore (majtas dhe dhjathtas) dhe një fshesë qendrore, sistem thithës të pluhurave (aspirator) dhe sistem spërkatje me ujë gjatë punës, me tub aspirimi të jashtëm thithës 800-1000 kg - 1 (një) copë; 2. Makina për lagjen e rrugëve, (autobot) me kapacitet mbajtës 9-10 m3 - 1 (një) copë; 3. Pompë dezinfektimi spërkatëse me pluhur e lëng -1 (një) copë. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga Operatori Ekonomik KURORA sh.p.k., nuk është provuar përmbushja e specifikimeve teknike të kërkuara nga Autoriteti Kontraktor për këto mjete, konkretisht nuk është provuar se: a) Për mjetin teknologjik autofshesë për fshirjen e rrugëve, dokumentacioni i paraqitur për mjetin teknologjik autofshesë nuk provon se disponon sistem thithës të pluhurave (aspirator) dhe as të jetë me tub aspirimi të jashtëm thithës 800-100kg. b) Për makinën e lagies së rrugës, dokumentacioni i paraqitur nuk provon kapacitetin mbajtës 9-

10 m3. c) Për pompën e disifektimit, nuk provohet nga dokumentacioni i paraqitur se pompë e dezifektimit nuk është spërkatëse me pluhur dhe lëng. Pavarësisht kësaj, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave (KVO) ka kryer një vlerësim tërësisht subjektiv, duke marrë të mirëqenë ekzistencën e këtyre karakteristikave, pa u mbështetur në dokumentacion provues, në kundërshtim të hapur me parimet dhe rregullat e prokurimit publik, sipas të cilave vlerësimi duhet të jetë i bazuar në prova shkresore dhe të verifikueshme. Në përputhje me nenin 77 të Ligjit nr. 162/2020 Për Prokurimin Publik, Autoriteti Kontraktor ka detyrimin të verifikojë përmbushjen e kriterëve të kualifikimit vetëm mbi bazën e dokumentacionit provues, të paraqitur nga operatorët ekonomikë. Në mungesë të një dokumentacioni të tillë, përmbushja e kriterëve nuk mund të prezumohet dhe as të merret e mirëqenë. Një qasje e tillë përbën trajtim preferencial, cenim të parimit të barazisë, parimit të ligjshmërisë etj. Nga ana tjetër, rezultojnë gjithashtu se vetë Autoriteti Kontraktor ka vendosur specifikime teknike për këto mjete/pajisje, të cilat, në raport me dokumentacionin e kërkuar, rezultojnë praktikisht të pamundura për tu verifikuar në mënyrë objektive. Kjo situatë krijon një standard vlerësimi të paqartë dhe të pambështetur në prova konkrete, duke e kthyer procesin në një vlerësim hamendësues dhe jo faktik”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.3.1. Në shtojcën 9/2 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, pika 2.3.2 “Kapaciteti teknik dhe profesional”, e modifikuar të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

Në pikën 2.3.6, “Kapaciteti teknik dhe profesional”, AK ka kërkuar: “2.3.6- **Disponimi ose mundësia e sigurt e disponimit në paisjet/kapacitetet e mëposhtme teknike, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës:**

- 1- Mjet teknologjik transporti veteshkarkues, për largimin e mbetjeve urbane, me ngarkim fundor ose anësor, me kapacitet mbajtës jo më pak se 10 ton - 1 (një) copë;
- 2- Mjet teknologjik transporti veteshkarkues rezervë, për largimin e mbetjeve urbane, me ngarkim fundor ose anësor, me kapacitet mbajtës jo më pak se 10 ton - 1 (një) copë;
- 3- Mjet teknologjik transporti veteshkarkues, për largimin e mbetjeve urbane, me ngarkim fundor ose anësor, me kapacitet mbajtës 3 - 4 ton - 1 (një) copë;
- 4- Mjet transporti me vinç për transportimin e kontenerëve për larje, pemëve, tapetit të barit, etj. me kapacitet mbajtës jo më pak se 10 Ton - 1 (një) copë;
- 5- Mjet teknologjik autofshesë për fshirjen e rrugëve, të pajisura me 2 fshesa anësore (majtas dhe djathtas) dhe një fshesë qendrore, sistem thithës të pluhurave (aspirator) dhe sistem spërkatje me ujë gjatë punës, me tub aspirimi të jashtëm thithës 800-1000 kg - 1 (një) copë;
- 6- Makina për lagjen e rrugëve, (autobot) me kapacitet mbajtës 9-10 m3 - 1 (një) copë.

- 7- *Makineri hidrombjellje për mbjelljen e barit në sipërfaqet e pjerrëta të qytetit me kapacitet 1000-1500 litra - 1 (një) copë;*
- 8- *Kamioncinë 7 vende të ulura (6+1) dhe kapacitet mbajtes 1- 1,5 Ton për transportimin e punonjësve, mjeteve e pajisjeve të punës,etj. - 1 (një) copë;*
- 9- *Motorrsekë - 2 (dy) copë;*
- 10- *Motosharrë krasitje - 1 (një) copë;*
- 11- *Pompë dezinfektimi spërkatese me pluhur e lëng -1 (një) copë;*
- 12- *Korrëse bari tip shkop - 1 (një) copë;*
- 13- *Korrëse bari me rrota - 2 (dy) copë;*
- 14- *Shkallë për krasitje në lartësi - 1(një) copë;*

Për mjetet e kërkuara operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin si më poshtë:

- 1- *Mjetet në pronësi duhet të shoqërohen me akt pronësie origjinal ose kopje të noterizuar (kontrata shit-blerje ose kontrata dhurimi).*
- 2- *Mjetet me qira duhet të shoqërohen me kontratë qiraje si dhe me aktin e pronësisë së qiradhënësit (origjinal ose kopje e noterizuar). Kontrata e qerasë duhet të përmbajë objektin dhe afatin e marrjes me qera të mjeteve (e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekti këti jprokurimi).*
- 3- *Për mjetet qe shënohen në regjistra publike duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin si: - leje qarkullimi; - certifikatën e kontrollit teknik; - siguracionin e mjetit;skedat teknike/katalog per te verifikuar kapacitetet e kerkuara nga AK ne mungese te tyre OE ofertues duhet te paraqese nje vetedeklarim ku te shprehen qarte kapacitetet per cdo mjet dhe AK rezervon të drejtën për verifikimin e vetëdeklarimit në procesin e vlerësimit të dokumentacionit. Ky dokumentacion duhet të jetë i vlefshëm.*
- 4- ***Per mjetet me qira***, duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e tij: - certifikatën e kontrollit teknik; - siguracionin e mjetit; skedat teknike/katalog per te verifikuar kapacitetet e kerkuara nga AK ne mungese te tyre OE ofertues duhet te paraqese nje vetedeklarim ku te shprehen qarte kapacitetet per cdo mjet dhe AK rezervon të drejtën për verifikimin e vetëdeklarimit në procesin e vlerësimit të dokumentacionit - ***kontratën përkatëse të qerasë***, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi. Ky dokumentacion duhet të jetë i vlefshëm.

- 5- Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar, ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.
- 6- Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruar sipas shtojcës Nr. 10. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese).
- 7- Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar në pronësi ose me qira ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.

Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues, i cili vërteton disponimin e mjeteve të mësipërme, do të dorëzohet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.”

III.3.2. Në shtojcën 10 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit”, të dokumenteve standarde të tenderit të procedurës së prokurimit objekt - ankimi, Pjesa III “Kriteret e përzgjedhjes/kualifikimit” pika B “DEKLARATË “Për disoinimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen)”, autoriteti kontraktor ka përcaktuar si më poshtë vijon:

B: DEKLARATË

Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen)

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:	<u>Punonjës</u> Po [] Jo [] Nëse, po, numri i punonjësve:
Unë kam punonjësit e nevojshëm si dhe mjetet dhe makineritë për ekzekutimin e kontratës, siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar, nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti/enti kontraktor.	Profili i punonjësve <u>Makineri e mjete</u> Po [] Jo [] Nëse po, të listohen me të dhënat konkrete:

Emri, Mbiemri _____

Firma _____

Vula _____

Data e dorëzimit të deklaratës _____

III.3.3. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik nga operatori ekonomik “Kurora” SHPK, për përmbushjen e kriterëve të mësipërme, rezulton se ky i fundit ka paraqitur në SPE dokumentacionin si më poshtë vijon:

Shtojca 10 Formualri Përmbledhës Vetëdeklarimit i plotësuar në të gjitha fushat i firmosur dhe vulosur.

C: DEKLARATË

“PËR DISPONIMIN E MJETEVE/PAJISJE/MAKINERIVE TË NEVOJSHME PËR REALIZIMIN E PUNIMEVE OBJEKT KONTRATE:

Në cilësinë e operatorit ekonomik “KURORA” shpk, deklaroj nën përgjegjësinë time se, kam në dispozicion dhe/ose do të më vihen në dispozicion mjetet, pajisjet teknike dhe asetet e tjera fizike për të realizuar këtë kontratën, si më poshtë:

Në pronësi				
Lloji i Mjetit	Targa	Nr. Lejes qarkullimit	Nr. Shasisë	Të tjera
Mjet Teknologjik MAN – Kapaciteti mbajtes 10 TON			W 0	
Mercedes Benz Kapaciteti mbajtes 3-4 ton		E	W	
Mjet transporti me vinç – Mercedes Benz		EL	W	

KURORA

Mjet teknologjik autofshesë	A	ELD0218419	TEB50CC203813 4622	
Makineri Hidrombjellje	A	Dokument Zhdoganimi – R	Dokument Zhdoganimi – R	Dokument Zhdoganimi
Kamionicine 7 vendshe vendeshe	A	E	W	
Motorrseke	-	Ft. Nr. 25.02/2022, Ft. Nr. 27 dt.12.02.2022		
Motorsharre krasitje	N/A	Ft. Nr. 7 dt.12.02.2022	-	-
Pompe dezinfektimi pluhur dhe leng	N/A	Ft nr 10 dt 09.02.2022		
Korrese bari tip shkop	N/A	Ft nr 6 dt 14.02.2022		
Korrese bari me rrota	N/A	Ft nr 7 dt 14.02.2022		
Korrese bari me rrota	N/A	Ft nr 7 dt 31.02.2022		
Shkalle per punime ne lartesi	N/A	Ft nr 5 dt 17.02.2022		
Korrese bari me rrota	N/A	Ft nr 7 dt 10.02.2022		

Me qira					
Lloji i Mjetit	Targa e mjetit	Nr. Lejes qarkullimit të mjetit	Nr. Shasisë së mjetit	Nr. Kont së qerasë (noterisë)	Afati i kontratës qerasë(data e fillimit dhe mbarimit)

Tel: 069 20 22 858 / 069 60 64 888 - Email: info@kurorashpk.com



Mjet Teknologjik Mercedes Benz Kapaciteti mbajtes 10 TON	A	E	W	Nr repertori Nr.Koleksioni	Dt fillimi 13.03.2026-Dt. Mbarimi deri ne perfundimin e kryerjes se sherbimit per proceduren me nr REF-75749-02-10-2026
Autobot Uji	A		W	Nr repertori Nr koleksioni	Dt fillimi 13.03.2026 Dt. Mbarimi deri ne perfundimin e kryerjes se sherbimit per proceduren me nr REF-75749-02-10-2026

Dokumentacioni fizik i operatorit ekonomik “Kurora” SHPK dorëzuar pranë autoritetit kontraktor dhe ardhur me shkresën nr. 2108/1 prot, datë 26.05.2026 protokolluar me tonën me nr. 1243/10 prot., datë 29.05.2026, autoriteti kontraktor ka dërguar dokumentacionin e dorëzuar nga ana e operatorit ekonomik “Kurora” SHPK, gjithësej 848 faqe.

III.3.4. Në nenin 2 “Qëllimi i ligjit” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se: Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit public.

III.3.5. Në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se 1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisorsocial e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.

III.3.6. Në nenin 77 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionale ose tregtarë. Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet

kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiron vjetore minimale që kërkohej nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës. Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohej operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë. Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”.

III.3.7. Në neni 41 pika 2 dhe 4 “Kërkesa të vecanta për kontratat e shërbimeve”, të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se:

“2. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77 të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

4. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

- a) licenca profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose
- b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose
- c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose

ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

d) Në rastin e prokurimit të shërbimeve me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posacme 41stafi i angazhuar të paraqesë deklaratë disponueshmërie për kryerjen e shërbimeve që ka marrë përsipër të realizojë”.

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së, i ndryshuar, përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”.

III.3.8. Në pikat 1 dhe 2 të nenit 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar përcaktohet se:

“1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik. Kur autoriteti ose enti kontraktor mund t'i marrë dokumentet mbështetëse duke u futur direkt në një bazë të aksesueshme të dhënash shtetërore, në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit përcaktohet edhe informacioni që kërkohe për këtë qëllim, siç është adresa në internet e bazës të të dhënave, çdo e dhënë identifikimi dhe, sipas rastit, në deklaratën e nevojshme për dhënien e pëlqimit. Operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

2. Në çdo kohë gjatë procedurës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë ofertuesve dhe kandidatëve sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, kur kjo është e nevojshme për të garantuar zbatimin korrekt të procedurës”.

III.3.9. Në nenin 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, pikat 1, 2, 3, 6 dhe 7 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet se:

1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.

2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarin, si më poshtë vijon:

a) operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;

b) operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

- c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;
- ç) operatori ekonomik nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- d) operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi;
- dh) operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve 20të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së;
- e) operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë;
- ë) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- f) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës;
- g) operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- gj) operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor;
- h) operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti);
- i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti;
- j) informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet, nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm, nëse është rasti;
- k) operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- l) operatori ekonomik ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi;
- ll) operatori ekonomik i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë.

3. Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.

6. Në procedurat e prokurimit me një fazë, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i” dhe “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Në procedurat e prokurimit me faza, ky dokumentacion i kërkohet të gjithë kandidatëve të kualifikuar në fazën e parë, përpara nisjes së afateve të ankimit. Ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të dorëzojë dokumentat provuese, të cilat duhet të jenë në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin. Për dokumentat e ofertës, të ngarkuara në sistemin e prokurimit elektronik, ofertuesi i kualifikuar i pari duhet t'i paraqesë këto dokumenta në

original ose të njësuara me origjinalin. Gjithashtu, dokumentet provuese, që do të paraqiten për të provuar vetëdeklarimet e bëra, duhet të paraqiten në original ose të njësuara me origjinalin dhe të provojnë gjendjen faktike të ofertuesit në kohën e ofertimit të tij. Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike. Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj. Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.

7. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime." Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

III.3.10. Në nenin 47 "Klasifikimi i mjeteve rrugore" të ligjit nr. 8378, datë 22.07.1998 "Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar parashikohet se:

1. Mjetet, sipas qëllimeve të përcaktuara në këtë Kod, klasifikohen si vijon:

- a) mjete që lëvizin me forcën e krahut;
- b) mjete të tërhequra me kafshë;
- c) mjete me pedal;
- d) slita;
- e) ciklomotori;
- f) motomjete;
- g) automjete;
- h) trolejbusë;
- i) rimorkio;
- j) makina bujqësore;
- k) makina teknologjike;
- l) mjete rrugore të veçanta.

2. Mjete me motor dhe rimorkiot e tyre, sipas shkronjave "e", "f", "g", "h", "i" "j" dhe "l", të pikës 1, të këtij neni, klasifikohen, gjithashtu, në bazë të kategorive ndërkombëtare si më poshtë:

a) - *Kategoria L1: mjete me dy rrota, cilindrata e motorit (kur flitet për motor me djegie të brendshme) të mos i kalojë 50 cm³ dhe me shpejtësi maksimale të projektuar (për çdo lloj sistemi motorik) jo më të madhe se 45 km/h, fuqia maksimale nuk është më shumë se 4 kË në rastin e një motori elektrik;*

- *Kategoria L2: mjete me tri rrota, cilindrata e motorit (kur flitet për motor me djegie të brendshme) të mos i kalojë 50 cm³ dhe me shpejtësi maksimale të projektuar (për çdo lloj sistemi motorik) jo më të madhe se 45 km/h; rendimenti maksimal neto i fuqisë nuk është më shumë se 4 kË, në rastin e motorëve të tjerë me djegie të brendshme, ose fuqia maksimale e vazhdueshme nuk është më shumë se 4 kË, në rastin e një motori elektrik;*

- *Kategoria L3: mjete me dy rrota, pa kosh, cilindrata e motorit (kur flitet për motor me djegie të brendshme) është më e madhe se 50 cm³ dhe me shpejtësi maksimale të projektuar*

(për çdo lloj sistemi motorik) më të madhe se 45 km/h;

- *Kategoria L4: mjete me dy rrota, me kosh, cilindrata e motorit (kur flitet për motor me djegie të brendshme) është më e madhe se 50 cm³ dhe me shpejtësi maksimale të projektuar (për çdo lloj sistemi motorik) më të madhe se 45 km/h;*

- *Kategoria L5: mjete me tri rrota të përshtatura simetrikisht, cilindrata e motorit (kur flitet për motor me djegie të brendshme) është më e madhe se 50 cm³ dhe me shpejtësi maksimale të projektuar (për çdo lloj sistemi motorik) më të madhe se 45 km/h;*

- *Kategoria L6: mjete me katër rrota të lehta, masa e pangarkuar e të cilave nuk është më shumë se 350 kg, pa përfshirë masën e baterive në rastin e automjeteve elektrike, me shpejtësi maksimale të projektuar jo më të madhe se 45 km/h, cilindrata e motorit të mos i kalojë 50 cm³ dhe rendimenti maksimal neto i të cilëve nuk është më shumë se 4 kË, në rastin e motorëve të tjerë me djegie të brendshme, ose fuqia maksimale e vazhdueshme e të cilëve nuk është më shumë se 4 kË, në rastin e një motori elektrik;*

- *Kategoria L7: mjete me katër rrota të ndryshme nga L6, masa e pangarkuar e të cilave nuk është më shumë se 400 kg (550 kg për automjetet e synuara për transportimin e mallrave), pa përfshirë masën e baterive, në rastin e automjeteve elektrike, dhe fuqia maksimale neto e motorit e të cilave nuk është më shumë se 15 kË;*

b) - *kategoria M: mjete me motor të destinuara për transport njerëzish dhe që kanë të paktën katër rrota;*

- *kategoria M1: mjete të destinuara për transport njerëzish dhe që nuk kanë më shumë se tetë ndenjëse, përveç ndenjësës së drejtuesit të mjetit;*

- *kategoria M2: mjete të destinuara për transport njerëzish dhe që kanë më shumë se tetë ndenjëse, përveç ndenjësës së drejtuesit të mjetit dhe peshë maksimale me ngarkesë deri 5 tonë;*

- *kategoria M3: mjete të destinuara për transport njerëzish dhe që kanë më shumë se tetë ndenjëse, përveç ndenjësës së drejtuesit të mjetit dhe peshë maksimale me ngarkesë më të madhe se 5 tonë;*

c) - *kategoria N: mjete me motor të destinuara për transport mallrash dhe që kanë të paktën katër rrota;*

- *kategoria N1: mjete të destinuara për transport mallrash dhe që kanë peshë maksimale me ngarkesë jo më të madhe se 3,5 tonë;*

- *kategoria N2: mjete të destinuara për transport mallrash, me peshë maksimale me ngarkesë më të madhe se 3,5 tonë, por jo më të madhe se 12 tonë;*

- *kategoria N3: mjete të destinuara për transport mallrash, me peshë maksimale me ngarkesë më të madhe se 12 tonë;*

d) - *kategoria O: rimorkiot (përfshirë edhe gjysmërimorkiot);*

- *kategoria O1: rimorkio me peshë maksimale me ngarkesë jo më të madhe se 0,75 tonë,*

- *kategoria O2: rimorkio me peshë maksimale me ngarkesë më të madhe se 0,75 tonë, por jo më të madhe se 3,5 tonë;*

- *kategoria O3: rimorkio me peshë maksimale me ngarkesë më të madhe se 3,5 tonë, por jo më të madhe se 10 tonë;*

- *kategoria O4: rimorkio me peshë maksimale me ngarkesë më të madhe se 10 tonë.*

dh) - *Kategoria T: traktorët me rrota;*

- *Kategoria T1: traktorët me rrota, me shpejtësi maksimale në kushte sigurie prej jo më shumë se 40 km/h, me boshtin më të afërt të drejtuesit, që ka gjerësi minimale zinxhiri prej jo*

më pak se 1150 mm, me një masë të pangarkuar në rend të njëpasnjëshëm prej më shumë se 600 kg dhe me lartësi nga toka prej jo më shumë se 1 000 mm;

- *Kategoria T2: traktorët me rrota, me shpejtësi maksimale në kushte sigurie prej jo më shumë se 40 km/h, me gjerësi minimale zinxhiri prej më pak se 1150 mm, e një masë të pangarkuar në rend të njëpasnjëshëm prej më shumë se 600 kg dhe me lartësi nga toka prej jo më shumë se 600 mm;*

- *Kategoria T3: traktorët e pajisur me rrota, me shpejtësi maksimale në kushte sigurie prej jo më shumë se 40 km/h dhe me një masë të pangarkuar në rend të njëpasnjëshëm prej jo më shumë se 600 kg;*

- *Kategoria T4: traktorët e pajisur me rrota për qëllime të veçanta, me shpejtësi maksimale në kushte sigurie prej jo më shumë se 40 km/h;*

- *Kategoria T5: traktorët e pajisur me rrota me shpejtësi maksimale në kushte sigurie prej jo më shumë se 40 km/h;*

- *Kategoria C: traktorët me zinxhirë të pandërprerë;*

Traktorët me zinxhirë të pandërprerë që shtyhen dhe drejtohen nga zinxhirë të pandërprerë dhe kategoritë e të cilëve, C1 deri C5, përcaktohen në analogji me kategoritë T1 deri T5.

III.3.11. Në nenin 54 “Automjetet” të ligjit nr. 8378, datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar parashikohet se:

1. Automjetet janë mjete me motor me të paktën katër rrota, me përjashtim të autokarrove. Automjetet ndahen në:

a) *Autovetura: mjete të destinuara për transport njerëzish, që kanë maksimumi nëntë ndenjëse, duke përfshirë edhe ndenjësen e drejtuesit të mjetit;*

b) *Autobus: mjet i destinuar për transport njerëzish me më shumë se nëntë ndenjëse, duke përfshirë edhe ndenjësen e drejtuesit të mjetit;*

c) *Automjet për transport të përzier: mjet që ka një peshë të përgjithshme me ngarkesë të plotë jo më të madhe se 3.5 tonë, ose 4.5 tonë kur ka tërheqje elektrike a me bateri; janë të destinuara për transport njerëzish dhe mallrash me kapacitet maksimal nëntë ndenjëse, duke përfshirë edhe ndenjësen e drejtuesit të mjetit;*

d) *Kamion: mjet i destinuar për transportin e mallrave dhe të njerëzve të caktuar me përpunimin ose transportin e këtyre mallrave;*

e) *Tërheqës: mjet i destinuar vetëm për tërheqjen e rimorkiove ose gjysmërimorkiove;*

f) *Automjet për transport të veçantë: mjet transporti i destinuar për transportin e disa mallrave ose njerëzve të caktuar në kushte të veçanta dhe karakterizohet nga pajisja në mënyrë të përhershme, me mekanizma specialë që i shërbejnë këtij qëllimi;*

g) *Automjet që përdorim të veçantë: mjete të pajisura në mënyrë të përhershme me mekanizma të veçantë dhe të destinuar përgjithësisht për transportin e këtyre mekanizmave; mbi këto automjete lejohet transporti i personelit dhe materialeve që kanë lidhje me ciklin operativ të këtyre mekanizmave, si dhe transporti i njerëzve dhe mallrave që kanë lidhje me destinacionin e përdorimit të këtyre mekanizmave.*

h) *Autotrenat: komplekse mjete të përbëra nga dy njësi të veçanta të lidhura bashkë, nga të cilat njëra është udhëzuese; vetëm për zbatimin e nenit 61, pikat 1 dhe 2, autotrenat që kanë në mënyrë të përhershme pajisje të veçanta për transportin e mallrave të përcaktuar në aktet*

në zbatim, do të përbëjnë një njësi të vetme. Në çdo rast, nëse tejkalohen përmasat gabaritë kufitare të përcaktuara në nenin 61, mjeti ose transporti konsiderohet jashtë norme;

i) Gjysmërimorkiatorë: mjete të përbëra nga një tërheqës dhe nga një gjysmërimorkio;

j) Artikular: është autobus i përbërë nga dy pjesë të ngurta të lidhura ndërmjet tyre nëpërmjet një mekanizmi të artikuluar; në këta tipa mjetesh pasagjerët e secilës pjesë qarkullojnë lirisht nga njëra te tjetra; ndarja ose lidhja e të dy pjesëve të mjetit me njëra-tjetrën bëhet vetëm në ofiçinë; k) Autokampe: mjete që kanë një karroceri speciale dhe janë të pajisur në mënyrë të përhershme për t'iu përshtatur transportit dhe strehimit të deri shtatë njerëzve, duke përfshirë edhe drejtuesin e mjetit;

l) Makina ngarkim-transporti: mjete ose komplekse mjetesh që kanë pajisje të veçanta për ngarkimin dhe transportin e materialeve që përdoren, ose janë produkt i punimeve të ndërtimit dhe të gërmimeve në miniera, si dhe të materialeve që plotësojnë gjatë ecjes ciklin e prodhimit të tyre; këto mjete ose komplekse mjetesh mund të përdoren në transporte që kalojnë kufirin e ngarkesës të përcaktuar në nenin 62, por jo atë të nenit 10, pika 8; në çdo rast nuk duhet të kalojnë përmasat gabaritë kufitare të përcaktuara në nenin 61; makinat e ngarkim-transportit duhet, gjithashtu, të jenë të përshtatshme për t'u përdorur në kantiere ose për përdorim të përzier në rrugë dhe jashtë saj.

2. Në aktet në zbatim përcaktohen, sipas pajisjeve të tyre shoqëruese, tipat e automjeteve që regjistrohen si automjete për transporte të veçanta dhe si automjete për përdorime të veçanta.

III.3.12. Në nenin 56 “Automjetet” të ligjit nr. 8378, datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar parashikohet se:

1. Rimorkiot janë mjete të destinuara për t'u tërhequr nga automjetet, për të cilat flitet në nenin 54, dhe nga trolejbuset për të cilët flitet në nenin 55, duke përjashtuar artikulet.

2. Rimorkiot ndahen në:

a) rimorkio ose gjysmërimorkio për transport pasagjerësh, ku përfshihen rimorkiot me të paktën dy akse;

b) rimorkio për transport mallrash;

c) rimorkio për transport të veçantë, sipas kuptimit përkatës që është dhënë në shkronjën “f” të nenit 54;

d) rimorkio për përdorim të veçantë, sipas kuptimit të dhënë në shkronjat “g” dhe “h” të nenit 54;

e) rimorkio kamp: rimorkio me një aks ose me dy akse të vendosura në një largësi jo më shumë se një metër, që kanë një karroceri të veçantë dhe të pajisur për t'u përdorur si vendstrehim, por vetëm kur mjeti është i ndalur;

f) rimorkio për transportin e pajisjeve turistike dhe sportive: rimorkio me një aks ose me dy akse të vendosura në një largësi jo më shumë se një metër, të cilat kanë pajimin e nevojshëm për transportimin e pajisjeve turistike dhe sportive, si barka, planera etj.

3. Gjysmërimorkiot janë mjete të ndërtuara në mënyrë të tillë që një pjesë e tyre t'i mbivihet njësisë motorike dhe që një pjesë e konsiderueshme e ngarkesës së saj të mbahet ngakjo njësi.

4. Karrelat janë mjete shtojcë që nuk kanë më shumë se dy rrota dhe janë të destinuara për transport bagazhi, pajisjesh etj. si këto; tërhiqen nga automjetet, për të cilat flitet në nenin 54, pika 1, duke përjashtuar ato për të cilat flitet në shkronjat “h”, “i” dhe “l”. Karrelat

konsiderohen pjesë përbërëse e automjeteve, kur hyjnë brenda përmasave gabaritë kufitare dhe të ngarkesës së lejuar të përcaktuar nga nenet 61 dhe 62.

III.3.13. Në nenin 198 “Motomjetet për transporte të veçanta dhe motomjete për përdorim të veçantë (Neni 53 i Kodit Rrugor)” të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 153, datë 07.04.2000 “Për Miratimin e Rregullores së Zbatimit të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar parashikohet se:

1. Në bazë të nenit 53, pika 1 e Kodit Rrugor, janë klasifikuar për transporte të veçanta, motomjetet e pajisura përgjithmonë me njërën nga karrocetë, si vijon:

- a) dhomë izometrike ose e zbuluar, me ose pa grup frigoriferik, e vlerësuar si e përshtatshme për transportin e ushqimeve në një regjim me temperaturë të kontrolluar;
- b) kazan i kthyeshëm, i mbyllur, me hapje vetëm nga sipër ose nga prapa, për transportin e mbeturinave të forta;
- c) cisterna për transportin e lëngjeve apo të ujërave të zeza;
- ç) cisterna apo kontenierë të pajisur posaçërisht për transportin e materialeve të shkrira apo në formë pluhuri;
- d) karrocetë të tjera, të vlerësuara të përshtatshme për transport të veçantë nga Ministria e Transportit.

2. Klasifikohen për përdorim të veçantë, sipas nenit 53, pika 1 e Kodit Rrugor, motomjetet si vijon:

- a) të pajisura me shkallë;
- b) të pajisura me pompë;
- c) të pajisura me vinç gru;
- ç) të pajisura me pedane apo me kosh të ngritshëm;
- c) të pajisura për ekspozime reklamash;
- dh) të pajisura me pastrues;
- d) të pajisura me ujitës;
- ë) të pajisura me ambulancë apo me laborator të lëvizshëm;
- e) të pajisura me saldatrëçe;
- f) të pajisura me gërmuese;
- gj) të pajisura me shpues;
- g) të pajisura me sharrë;
- h) të pajisura me gjenerator;
- i) të pajisura me vegla të tjera, të vlerësuara, nga Ministria e Transportit të përshtatshme për përdorime të veçanta.

3. Motomjeteve të përdorimeve të veçanta, në lejen e qarkullimit u shënohet një kapacitet fiktiv, për qëllime fiskale (taksash), që përcaktohet nga diferenca ndërmjet peshës së përgjithshme të mjetit dhe tarës së këtij mjeti, të pajisur me karrocetë normale ose, kur nuk ekziston ky version, me tarën (pesha bosh) e motomjetit (pa karrocetë) të rritur me 20 për qind.

III.3.14. Në nenin 201 “Automjetet për transport dhe për përdorim të veçantë (Neni 54 i Kodit Rrugor)” të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 153, datë 07.04.2000 “Për Miratimin e

Rregullores së Zbatimit të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar parashikohet se:

1. Sipas nenit 54, pika 2 e Kodit Rrugor, klasifikohen automjete për transporte të veçanta ato automjete, të pajisura me njërën nga karroceritë e poshtëshënuara:

- a) dhomë izotermike apo e izoluar, me apo pa grup frigoriferik, e njohur si e përshtatshme për transportin e ushqimeve në regjim frigoriferik, në temperaturë të kontrolluar;*
- b) karroceri të përshtatshme për ngarkimin, përpunimin, transportin dhe shkarkimin e mbeturinave të forta të qyteteve;*
- c) cisternat për transportin e lëngjeve apo të ujërave të zeza;*
- ç) cisterna apo kontenierë, të pajisur posaçërisht për transportin e materialeve të shkrira dhe në formë pluhuri;*
- d) shasi, të pajisura me sisteme kapëse për transportin e kontenierëve apo të shtëpive të lëvizshme, të tipit të unifikuar;*
- dh) shasi me krahë për transportin e trupave të lidhur;*
- e) betoniere;*
- ë) karroceri për transportin e personave në kushte të veçanta dhe që dallohen me anë të një pajisjeje të veçantë, të përshtatshme për këtë qëllim;*
- f) karroceri të pajisura në mënyrë të veçantë për transportin e materialeve të klasifikuara të rrezikshme nga ADR-ja apo në bazë të normativave përkatëse të Komunitetit European;*
- g) karroceri të veçanta, me udhëzues rrotash dhe plan të pjerrët ngarkimi, të caktuara vetëm për transport automjetesh;*
- gj) karroceri të tjera, të njohura nga Ministria e Transportit si të përshtatshme për transporte të veçanta.*

2. Klasifikohen, në bazë të nenit 54, pika 2 e Kodit Rrugor, për përdorim të veçantë, automjetet e mëposhtme:

- a) traktori rrugor;*
- b) autopastruesja;*
- c) autopompa;*
- ç) autopastruesja e borës;*
- d) autoujitësja;*
- dh) autoofiçina;*
- e) automjetet e shkallës dhe automjetet për riparimin e linjave elektrike;*
- ë) automjetet me vinç gru;*
- f) automjetet për ndihmën e shpejtë në rrugë;*
- g) automjetet me pedane apo kosh të ngritshëm;*
- gj) autobluajtësja shkoqëse;*
- h) autofshirësja;*
- i) autoambulanca;*
- j) automjetet e varrimit;*
- k) autofurgonët e blinduar, për transportin e të burgosurve;*
- l) automjetet për dezinfektim;*

m) autoreklammat dhe mjetet për ekspozime reklamash, të pajisura me karroceri të veçantë për këtë funksion, që nuk lejon përdorime të tjera dhe ku sendet që transportohen nuk hiqen kurrë nga mjeti;

n) automjetet për radio, televizion, kinema;

o) automjetet e caktuara për shfaqje në lëvizje;

p) automjetet e pajisura me ambulanca të lëvizshme;

q) autotendat;

r) automjetet e pajisura për spërkatje të fushave;

rr) autosaldatrici;

s) automjet me aparatura telegrafike;

sh) autogërmuesja;

t) autoshpuesja;

th) autosharra;

u) automjetet e pajisura me gjenerator;

v) autopompa për beton;

z) automjetet e tjera të pajisura me vegla të njohura nga Ministria e Transportit, të përshtatshme për përdorim të veçantë.

3. Për automjetet e transporteve dhe të përdorimeve të veçanta, në lejen e qarkullimit u shënohet një kapacitet fiktiv për qëllime fiskale (taksash), i cili përcaktohet nga diferenca ndërmjet peshës së përgjithshme të mjetit dhe tarës së këtij mjeti të pajisur me karroceri normale ose, kur nuk ekziston ky version, me tarën e automjetit (pa karroceri) të rritur me 20 për qind.

III.3.15. Në nenin 202 “Rimorkiot për transport dhe përdorim të veçantë (Neni 56 i Kodit Rrugor)” të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 153, datë 07.04.2000 “Për Miratimin e Rregullores së Zbatimit të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar parashikohet se:

1. Klasifikohen, në bazë të nenit 56, pika 2, shkronja “c” e Kodit Rrugor, për transport të veçantë, rimorkiot dhe gjysmërimorkiot e pajisura me njërën nga karroceritë e mëposhtme, të vendosura në mënyrë të përhershme:

a) dhomë izotermike apo e izoluar, me ose jo grup frigoriferik, që është e përshtatshme për transportimin e ushqimeve në një regjim temperature të kontrolluar;

b) karroceri të përshtatshme për ngarkimin, përpunimin, transportimin dhe shkarkimin e plehrave të forta të qyteteve;

c) cisternat për transportimin e lëngjeve dhe të ujërave të zeza;

ç) cisterna apo kontenierë, të pajisur posaçërisht për transportin e materialeve të shkrira apo në formë pluhuri;

d) shasi, të pajisura me sisteme kapjeje për transportin e kontenierëve apo të shtëpive të lëvizshme, të tipit të unifikuar;

dh) shasi me krahë për transportin e trupave të lidhur;

e) betoniere;

ë) karroceri të caktuara për transportin e personave në kushte të veçanta dhe të dallueshme nga një pajisje e përshtatshme për këtë qëllim;

f) karroceri, të pajisura posaçërisht për transportin e materialeve të klasifikuara të rrezikshme në bazë të ADR-së apo të normativave përkatëse të Komunitetit Europian;

g) karroceri e veçantë, me udhëzues rrotash dhe plan të pjerrët ngarkimi, e përshtatshme për transportin e makinave;

gj) karroceri të tjera, të njohura nga Ministria e Transportit si të përshtatshme për transport të veçantë.

2. Klasifikohen, në bazë të nenit 56, pika 2, shkronja “d” e Kodit Rrugor, për përdorim të veçantë, këto rimorkio:

a) të caktuara vetëm për t’u shërbyer automjeteve për përdorim të veçantë;

b) të karrocuara në përputhje me automjetin për përdorim të veçantë, të cilit i është caktuar;

c) të përshtatura për transportin në rrugë të mjeteve hekurudhore.

3. Për rimorkiot e përdorimeve të veçanta, në lejen e qarkullimit shënohet një kapacitet fiktiv për qëllime fiskale (taksash), që përcaktohet nga diferenca ndërmjet peshës së përgjithshme të mjetit dhe tarës së këtij mjeti të pajisur me karroceri normale ose, kur nuk ekziston ky version, me tarën e rimorkios (pa karroceri), të rritur me 20 për qind.

III.3.16. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt-prokurimi. KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi. KPP-ja gjykon, se vetë ligjvënësi ka parashikuar në nenin 2 gërma “dh”, se qëllimi i ligjit të prokurimit publik nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar si ligj material i zbatueshëm për shqyrtimin administrativ të ankesave të operatorëve ekonomikë, është ndër të tjera të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik. Ashtu si edhe GJED ka nënvizuar ndër vite, parimi i transparencës dhe barazisë janë të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën, por detyra thelbësore e transparencës në një procedurë prokurimi është që të krijohen kushte dhe rregulla të hollësishme për të gjithë palët në proces.

III.3.17. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, nëpërmjet kriterëve për kualifikim, synohet sigurimi i ofertimit nga operatorë ekonomikë të përgjegjshëm, të cilët janë krijuar dhe veprojnë sipas legjislacionit shqiptar në fuqi apo legjislacionit të shtetit të origjinës. Kriteret kualifikuese të përcaktuara në dokumentet e tenderit janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Për pasojë, Komisioni gjykon, se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi duhet të plotësojnë vetëm kërkesat e vendosura në dokumentet e tenderit, e rrjedhimisht, vlerësimi e kualifikimi i tyre duhet të bëhet në përputhje vetëm me këto kërkesa. Nisur nga pretendimet më sipër të ankimesit, për skualifikimin e operatorit ekonomik “Kurora” SHPK, Komisioni nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në sistemin e prokurimit elektronik nga operatori ekonomik “Kurora” SHPK, konstaton, se ky i fundit ka paraqitur Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, të firmosur dhe vulosur, ku për përmbushjen e pikës 2.3.6 në kriteret e veçanta të kualifikimit ka kryer deklaratimet si në pikën III.3.3 të këtij vendimi. Duke qenë se operatori ekonomik “Kurora” SHPK, sipas vendimit të KVO-së është operatori ekonomik i kualifikuar i pari në këtë procedurë prokurimi, në zbatim të nenit 26, pika 6, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ka paraqitur pranë autoritetit kontraktor dokumentet provuese të parashikuara në pikë 2, të nenit 26 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, dokumente të cilat autoriteti kontraktor i ka vënë në dispozicion të KPP-së me shkresën nr. 2108/1 prot, datë 26.05.2026 protokolluar me tonën me nr. 1243/10 prot., datë 29.05.2026, bashkë me dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike në brendësi të të cilit gjendet dokumentacioni për përmbushjen e pikës 2.3.6 të kapacitetit teknik në kriteret e veçanta të kualifikimit. Duke marrë shkas nga pretendimet e ankimesit, se *nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga Operatori Ekonomik KURORA sh.p.k., nuk është provuar përmbushja e specifikimeve teknike të kërkuara nga Autoriteti Kontraktor për këto mjete, konkretisht nuk është provuar se: a) Për mjetin teknologjik autofshesë për fshirjen e rrugëve, dokumentacioni i paraqitur për mjetin teknologjik autofshesë nuk provon se disponon sistem thithës të pluhrave (aspirator) dhe as të jetë me tub aspirimi të jashtëm thithës 800-1000 kg. b) Për makinën e lagies së rrugës, dokumentacioni i paraqitur nuk provon kapacitetin mbajtës 9-10 m3. c) Për pompën e disifektimit, nuk provohet nga dokumentacioni i paraqitur se pompë e dezifektimit nuk është spërkatëse me pluhur dhe lëng dhe duke i ballafaquar me pikën 2.3.6 të kapacitetit teknik në kriteret e veçanta të kualifikimit, dokumentacionin e ngarkuar në sistemin e prokurimit elektronik nga operatori ekonomik “Kurora” SHPK , si dhe dokumentacionin fizik të paraqitur nga ky i fundit në autoritet kontraktor për përmbushjen e kriterit të cituar më sipër, KPP gjykon, se referuar përmbajtjes së formularit përmbledhës të ngarkuar në SPE nga operatori ekonomik “Kurora” SHPK konkretisht në pjesën III “Kriteret e përzgjedhjes/kualifikimit” pika C “DEKLARATË “Për disponimin e mjeteve/pajisjeve, makinerive të nevojshme për realizimin e punimeve objekt kontrate”, ka deklaruar në mënyrë të qartë me emërtim mjeti, targë, leje qarkullimi dhe numër shasie duke dhënë indicie mbi posedimin e tyre. Gjithashtu operatori ekonomik “Kurora” SHPK ka dorëzuar në autoriteti kontraktor në bazë të nenit 26 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave*

të prokurimit publik” i ndryshuar , dokumentacionin e deklaruar më sipër i cili shërben si provë për vertetimin e deklarimeve të bëra në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, me qëllim përmbushjen e kërkesave të autoritetit kontraktor. Duke marrë shkas nga pretendimet e ankimesit si dhe nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur fizikisht në autoritet kontraktor nga operatori ekonomik “Kurora” SHPK konkretisht:

- Leje Qarkullimi Nr.XXXXXXX, për mjetin me targë XXXXXXXX Mjet Teknologjik autofshësë për fshirjen e rrugëve (APV) Bucher Schorli City Cat 2020, në emër të Kurora SHPK. Taksa Vjetore e Mjetit. Certifikata e Kontrollit Teknik të Mjetit me targë XXXXXXXX. Polica Sigurimit nr. XXXXXXXX e Mjetit me targë XXXXXXXX. Certifikata e Pronësisë së Mjetit me targë XXXXXXXX. Foto të mjetit.

- Kontratë Qiraje nr. XXXXX rep dhe Nr. XXXXX Kol, datë XXXXXX.2026 lidhur ndërmjetë qiradhënësit “XXXXXX” shpk dhe qeramarrësit “Kurora” shpk, për mjetin me targë XXXXXXXX autobot uji, me afat 5 vite. Leje Qarkullimi Nr. XXXXXXXX, për mjetin me targë XXXXXXXX Automjet për transport të vecantë (ATV). Taksa Vjetore e Mjetit. Certifikata e Kontrollit Teknik të Mjetit me targë XXXXXXXX. Polica Sigurimit nr. XXXXXXXX e Mjetit me targë XXXXXXXX. Certifikata Nr XXXX, datë XXXXXXXX Për Transport Mallrash për Vete dhe të Tretë brenda Vëndit. Foto të mjetit.

- Faturë Tatimore Shitje Nr. XXXX, datë XXXXXXXX, Blerës Kurora shpk me përshkrim të mallit Pompë dezinfektimi spërkatëse pluhur + lëng me benzin.

Nisur nga pretendimet e ankimesit i cili kërkon të verifikohen përmbushja e specifikimeve teknike për Mjetin Teknologjik autofshësë për fshirjen e rrugëve, Autobot Uji dhe Pompë dezinfektimi spërkatëse pluhur + lëng, referuar dokumentacionit më sipër të paraqitur nga operatori ekonomik “Kurora” SHPK në autoritet kontraktor me qëllim përmbushjen e kriterit 2.3.6 të kapacitetit teknik rezulton se nga verifikimi i lejes së qarkullimit nr. XXXXXX për mjetin me targë XXXXXXXX Komisioni konstaton, se në lejen e qarkullimit në pikën F1. Masa maksimale e autorizuar (kg) përcaktohet XXXXXXX, ndërsa në pikën G. Masa e mjetit bosh (kg) përcaktohet XXXXXXX. Nga ky dokumentacion rezulton se, mjeti me targë XXXXXXX ka tonazh transportues XXXXXXX kg, duke përmbushur në këtë mënyrë kriterin e veçantë të kualifikimit pikën 2.3.6 të kriterëve të veçanta të kualifikimit. Në këto kushte pretendimi i ankimesit nuk qëndron. Sa i përket pajisjes Pompë dezinfektimi spërkatëse me pluhur e lëng, për të vërtetuar këtë pajisje operatori ekonomik “Kurora” SHPK ka paraqitur Faturë Tatimore Shitje Nr. XXXX, datë XXXXX, nga evidentimi i së cilës rezulton se përshkrimi i mallit është Pompë dezinfektimi spërkatëse pluhur + lëng me benzin, në përputhje me pajisjen e kërkuar nga ana e autoritetit kontraktor në pikën 2.3.6 “Kriteret e Vecanta të Kualifikimit” në dokumentat standarte të tenderit. Ndërsa sa i përket mjetit teknologjik autofshësë për fshirjen e rrugëve, operatori ekonomik ankimes për të vërtetuar disponueshmërinë e këtij mjeti ka paraqitur *Leje Qarkullimi Nr. XXXXXX, për mjetin me targë XXXXXXXX Mjet Teknologjik autofshësë për fshirjen e rrugëve (APV) Bucher Schorli City Cat 2020, në emër të Kurora SHPK. Taksa Vjetore e Mjetit. Certifikata e Kontrollit Teknik të Mjetit me targë XXXXXX. Polica Sigurimit nr. XXXXXXXX e Mjetit me targë XXXXXXXX. Certifikata e Pronësisë së Mjetit me targë XXXXXXXX. Foto të mjetit.* Në lidhje me këtë mjetë Komisioni kërkoi informacion nga

institucioni që merret me regjistrimin e mjeteve konkretisht nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugorë Tiranë, e cila me shkresën nr. 12009/1 prot, datë 10.06.2026, protokolluar me tonën me nr. 1243/12 prot, datë 12.06.2026, me objekt “Dërgim informacioni”, informon se: “Në vijim të shkresës suaj Nr. 1243/11 prot, datë 04.06.2026 “Kërkesë për informacion”, protokolluar në DPSHTRR me Nr. 12009 prot, datë 08.06.2026, ju informojmë si më poshtë: - Nga verifikimi i fotokopjes së lejes së qarkullimit, me nr. XXXXXXXX, të dërguar nga ana juaj dhe verifikimi i Regjistrimit Elektronik Kombëtar të Mjeteve, konfirmojmë se mjeti për të cilin bëhet fjalë është i llojit “Automjet për Përdorim të Veçantë (APV)”. Lloji i mjetit APV, është i evidentuar tëk fusha 1 e lejes së qarkullimit; - fuqia maksimale e motorit të këtij mjeti, që për rastin konkret është 55kË, evidentohet në fushën 13 të lejes së qarkullimit; - në lejen e qarkullimit evidentohet fuqia maksimale që prodhon motori i mjetit (jo fuqi thithëse mjeti). Kjo e dhënë merret nga dokumenti teknik shoqërues i mjetit i lëshuar nga prodhuesi ose nga autoriteti kompetent i shtetit nga i cili vjen ky mjet. Në rastin konkret, KPP konstaton se referuar kritereve të veçanta të kualifikimit autoriteti kontraktor në drejtim të plotësimit të kriterit për disponimin e mjeteve ka kërkuar nga ana e operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik detyrimin që për “Për mjetet që shënohen në regjistra publike duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin si: - leje qarkullimi; - certifikatën e kontrollit teknik; - siguracionin e mjetit; skedat teknike/katalog për të verifikuar kapacitetet e kërkuara nga AK në mungesë të tyre OE ofertues duhet të paraqesë një vetedeklarim ku të shprehen qarte kapacitetet për çdo mjet dhe AK rezervon të drejtën për verifikimin e vetedeklarimit në procesin e vlerësimit të dokumentacionit. Ky dokumentacion duhet të jetë i vlefshëm. Per mjetet me qira, duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e tij: - certifikatën e kontrollit teknik; - siguracionin e mjetit; skedat teknike/katalog për të verifikuar kapacitetet e kërkuara nga AK në mungesë të tyre OE ofertues duhet të paraqesë një vetedeklarim ku të shprehen qarte kapacitetet për çdo mjet dhe AK rezervon të drejtën për verifikimin e vetedeklarimit në procesin e vlerësimit të dokumentacionit - kontratën përkatëse të qerasë, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi. Ky dokumentacion duhet të jetë i vlefshëm. Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar, ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit. Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruar sipas shtojcës Nr. 10. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese)”. Komisioni gjykon se pretendimet e cituara në ankesës nuk janë të mbështetura, pasi referuar dokumentacionit të më sipërcituar të paraqitur nga operatori ekonomik “Kurora” SHPK pranë autoritetit kontraktor me qëllim përmbushjen e kriterit 2.3.6 të kapacitetit teknik dhe korespondencës me DPSHTRR rezulton e provuar që ky operator ekonomik i disponon mjetet për të cilat ngrihen pretendime në ankesë. Komisioni gjykon, se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi duhet të plotësojnë kërkesat e vendosura në dokumentet e tenderit, e rrjedhimisht, vlerësimi e kualifikimi i tyre duhet të bëhet në përputhje vetëm me këto kërkesa. Në mënyrë eksplicite, ligji për prokurimin publik parashikon, se vlerësimi i ofertave duhet bërë vetëm në përputhje me kriteret e kualifikimit të parashikuara në dokumentet e procedurës përkatëse. KPP gjykon se në cilësinë e një organi quazi gjyqësor, në vendimarrjen e tij, ky i fundit i referohet parimeve të së drejtës Judicis est judicare secundum allegata et probate (organi vendos në bazë të fakteve dhe provave të administruara në proces).

Për më tepër, Komisioni i Prokurimit Publik sqaron, se përfituesi i drejtpërdrejtë i objektit të prokurimit është vetë autoriteti kontraktor dhe si i tillë ai ka një pozitë të veçantë dhe është përgjegjës për ndjekjen dhe monitorimin e zbatimit të kontratës sipas legjislacionit në fuqi, kjo bazuar në nenin 124 të LPP-së ku përcaktohet se: *“1. Autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të ndjekë zbatimin e kontratës sipas kushteve në bazë të të cilave është nënshkruar, për të garantuar se ajo zbatohet në kohën, cilësinë dhe vlerën e përcaktuar, në përputhje me kushtet e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe me legjislacionin në fuqi. 2. Për monitorimin e zbatimit të kontratës, autoriteti ose enti kontraktor, nisur nga natyra e objektit të kontratës dhe kohëzgjatja e zbatimit të saj, harton planin e zbatimit të kontratës, duke përfshirë në veçanti çështjet organizative, afatet, çështjet ekonomike e teknike të kontratës së nënshkruar, në përputhje me çdo akt tjetër ligjor. 3. Plani i zbatimit të kontratës duhet të nënshkruhet nga autoriteti ose enti kontraktor dhe operatori ekonomik brenda 7 ditëve nga nënshkrimi i kontratës dhe në çdo rast para fillimit të zbatimit të saj. 4. Çdo modifikim i kontratës në përputhje me nenin 127 të këtij ligji, pasqyrohet në planin e zbatimit. 5. Autoriteti ose enti kontraktor, në përputhje me planin, ndjek zbatimin e kontratës, administron dokumentacionin e monitorimit dhe harton raportet e monitorimit. 6. Rregulla të hollësishme për monitorimin e zbatimit të kontratave, sipas tipologjive të tyre, përcaktohen nga rregullat e prokurimit publik. Autoriteti kontraktor duhet të kryejë pagesat në favor të operatorëve ekonomikë, në përputhje me parashikimet e legjislacionit të fushës në fuqi”*. Pra është autoriteti kontraktor si organi me interes dhe përgjegjësi për realizimin me sukses të kontratës, është pikërisht ai që duhet të monitorojë zbatimin e kontratës për t’u siguruar nëse cilësia e punëve të kërkuara është e njëjtë me cilësinë e premtuar në ofertë dhe të përcaktuar në kontratë.

Për sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.4. Lidhur me kërkimin alternativ të operatorit ekonomik ankimues për anulimin e procedurës së prokurimit, me arsyetimin se kriteri dhe dokumentet e kërkuara e bëjnë të pamundur verifikimin objektiv të karakteristikave të mjeteve, Komisioni vëren se ky kërkim nuk kundërshton më mënyrën se si KVO ka zbatuar kriterin ndaj ofertës së “Kurora” SHPK, por ligjshmërinë, qartësinë dhe teknikën e hartimit të vetë kriterit. Përmbajtja e pretendimit, dhe jo emërtimi që i jep ankimuesi, përcakton momentin procedural të ushtrimit të tij. Anulimi i procedurë për të kundërshtuar kriteret në fazën e vlerësimit/skualifikimit do të cenonte sigurinë juridike, do të krijonte pasiguri procedurale dhe do ta detyronte autoritetin kontraktor të rihapte paligjshmërisht diskutimin mbi kritere që nuk janë ankimuar në kohë.

Në ligjin e Prokurimit Publik është perkluzive që operatori ka detyrimin të përgatisë ofertën sipas kriterëve dhe kushteve të përcaktuara në dokumentet e tenderit, për sa kohë i ka pranuar ato dhe nuk i ka bërë objekt ankimi.

III.4.1. Pretendimi i operatorit ekonomik mbi ligjshmërinë, proporcionalitetin, qartësinë apo mënyrën e formulimit të kriterit është ngritur jashtë momentit procedural të parashikuar nga ligji. Në procedurën objekt-shqyrtimi, e cila është mbi kufirin e lartë monetar, neni 110, pika 1, i LPP-së i jepte çdo operatori ekonomik të drejtën të kundërshtonte dokumentet e tenderit brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të kontratës ose i ndryshimit të dokumenteve. **Ky është afat prekluziv, me përfundimin e tij shuhet mundësia për të rihapur në një fazë të re**

të mëvonshme debatin mbi ligjshmërinë, proporcionalitetin, qartësinë ose mënyrën e provimit të kriterit. Afati nuk është një formalitet i parëndësishëm, por instrumenti që stabilizon rregullat e garës përpara hartimit dhe dorëzimit të ofertave.

Komisioni çmon se kompetenca e tij për të kontrolluar ligjshmërinë e akteve të lidhura me ankesën ***nuk përbën një afat të tretë ankimi dhe nuk e bën të pavlefshëm afatin prekluziv të nenit 110 të LPP-së.*** Ndërhyrja kryesisht ndaj dokumenteve të tenderit pas hapjes së ofertave mund të justifikohet vetëm në rrethana përjashtimore, kur konstatohet një paligjshmëri e qartë, e rëndë dhe objektive, e cila e bën të pamundur vijimin e ligjshëm të procedurës ose prodhon domosdoshmërisht trajtim diskriminues. Në çështjen konkrete nuk është provuar një situatë e tillë. ***Kriteri ka përcaktuar tipologjinë e mjeteve dhe ka parashikuar një mekanizëm të zbatueshëm prove, përmes dokumenteve teknike ose vetëdeklarimit të verifikueshëm.***

III.4.2. Krahas ankimit, neni 75 i LPP-së i garantonte operatorit ekonomik mjetin procedural të kërkesës për sqarime, jo më vonë se 6 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave. Nëse ankimuesi vlerësonte se dokumentet provuese ose mënyra e verifikimit të tyre ishin të paqarta, ai duhej të kërkonte sqarim ose të ushtronte ankim ndaj dokumenteve të tenderit në afatin ligjor. ***Mosushtimi i këtyre mjeteve nuk mund të kompensohet pas shpalljes së rezultatit, duke e paraqitur të njëjtin kundërshtim si shkak anulimi. Një qasje e kundërt do t'i lejonte operatorit të konkurrenës sipas një rregulli, të priste rezultatin dhe ta kundërshtonte rregullin vetëm nëse rezultati nuk i ishte i favorshëm, duke krijuar avantazh procedural dhe trajtim të pabarabartë ndaj pjesëmarrësve të tjerë.***

Në nenin 75, të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet se: “[...] 1. Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti ose enti kontraktor, i cili duhet t’i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 6 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave. Autoriteti kontraktor ose enti duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t’ua komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit. Në çdo rast, sqarimi i dokumenteve të tenderit nuk do të konsiderohet shtim, pakësim ose ndryshim i kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor në dokumentet e tenderit. 2. Autoriteti ose enti kontraktor, nga momenti i shpalljes së njoftimit të kontratës deri përpara mbarimit të afatit të fundit për dorëzimin e ofertave dhe për çfarëdolloj arsyeje, me nismën e vet ose me kërkesë të palëve të interesuara, mund të vendosë të bëjë ndryshime në dokumentet e tenderit përmes hartimit të një shtojce. Nëse ndryshimi i dokumenteve të tenderit bëhet në gjysmën e parë të afatit të pranimit të ofertave, autoriteti ose enti kontraktor mund të zgjasë afatin kohor të pritjes së ofertave. Nëse ndryshimi i dokumenteve të tenderit bëhet në gjysmën e dytë të afatit të pranimit të ofertave, autoriteti ose enti kontraktor zgjat afatin kohor për dorëzimin e ofertës me të paktën 10 ditë për procedurat mbi kufirin e lartë monetar dhe me të paktën 7 ditë për procedurat nën kufirin e lartë monetar.. [...]”

III.4.3. Ky përfundim është në vijimësi me praktikën e konsoliduar të Komisionit të Prokurimit Publik.

1. Vendim KPP nr. 572/2025, datë 29.04.2025 KPP shprehet se operatorët ekonomikë, përfshirë ankimuesin, kanë pasur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së ankesave mbi hartimin e dokumenteve të tenderit, sipas nenit 110/1 të ligjit nr. 162/2020. Më tej, KPP e cilëson afatin prekluziv, mosrespektimi i tij sjell humbjen e së drejtës për të ngritur më vonë pretendime mbi përmbajtjen e dokumenteve të tenderit. Arsyetoj se Anulimi i procedurës për të kundërshtuar kriteret në fazën e vlerësimit/skualifikimit do të cenonte sigurinë juridike, do të krijonte pasiguri procedurale dhe do ta detyronte autoritetin kontraktor të rihapte paligjshmërisht diskutimin mbi kriteret që nuk janë ankimuar në kohë.

2. Vendim KPP nr. 816/2025, datë 27.06.2025 KPP thotë se nëse operatori ekonomik kishte pretendime për kriteret apo specifikimet teknike të dokumenteve të tenderit, ai kishte momentin procedural për t'i goditur ato me ankesë sipas nenit 110/1 të ligjit nr. 162/2020. Akoma më tej nëse operatori kishte paqartësi mbi përmbushjen e kriterit, kishte mundësi të kërkonte sqarime sipas nenit 75 përpara dorëzimit të ofertës. Ligjvënësi e lidh mosankimimin e kriterit me detyrimin e operatorit që të përgatisë ofertën sipas kriterëve të publikuara, për sa kohë ato janë pranuar dhe nuk janë bërë objekt ankimi.

3. Vendim KPP nr. 520/2026, datë 21.04.2026 KPP shprehet qartë se nëse operatori ekonomik kishte pretendime mbi kërkesat e vendosura në dokumentet e tenderit, ai kishte momentin procedural për të paraqitur ankesë mbi hartimin e dokumenteve të tenderit sipas nenit 110/1. KPP përsërit ndarjen 10 ditë / 7 ditë, sipas vlerës së procedurës. KPP thekson se në rast paqartësie operatori kishte mjetin procedural të kërkesës për sqarime sipas nenit 75, dhe se oferta duhet të përgatitet sipas kriterëve të pranuar dhe të paankimuara.

4. Vendim KPP nr. 212/2026, datë 09.02.2026 KPP shprehet se nëse operatori kishte paqartësi mbi përmbushjen e kërkesës, ai kishte momentin procedural për të kërkuar sqarime sipas nenit 75, dhe se operatorët duhet të përgatisin ofertat sipas kriterëve të dokumenteve të tenderit kur ato janë pranuar dhe nuk janë ankimuar.

5. Vendim KPP nr. 365/2026, datë 09.03.2026 KPP përdor të njëjtën logjikë: nëse operatori kishte paqartësi mbi kriterin/kërkesën, duhej të kërkonte sqarime në kohë; përndryshe oferta vlerësohet mbi kriteret e publikuara dhe të paankimuara.

Pretendimi i operatorit ekonomik ankimiues “Alko Impex Construction” shpk nuk qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar; Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin

dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Alko Impex Construction” SHPK në procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-75749-02-10-2026 me objekt “Shërbimet publike të pastrimit e gjelbërimit në bashkinë Gramsh dhe Nj.A Pishaj dhe NJ.A Kodovjat për marrëveshjen kuadër me afat 4-vjeçar” me fond limit 197.492.000 (njëqind e nëntëdhjetë e shtatë milion e katërqind e nëntëdhjetë e dy mijë) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 30.03.2026 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Gramsh.
 2. Autoriteti kontraktor të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit..
 3. Ngarkohet zyra e financës, të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit, të tarifave financiare të paguara nga operatori ekonomik “Alko Impex Construction” SHPK.
 4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
 5. Kopje e këtij vendimi, i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Nënkryetar
Fioorent Zguro

